



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Pustec

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Tiranë, mars 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3-5
3.	<u>Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.</u>	5
II.	HYRJA	5
1.	Objektivat dhe qëllimi.	5-6
2.	Identifikimi i qështjes.	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve.	6-7
5.	Kriteret e vlerësimit.	7
6.	Standardet e auditimit.	7-8
7.	Metodat e auditimit.	9-10
8.	Dokumentimi i auditimit.	11
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin.	12
2.	Përshkrimi auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	12-13
2.1	AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK.	
1.1	Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike	13-18
1.2.	Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.	18
1.3.	Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.	18
2.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	19
2.1	Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;	19-23
2.2	Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;	23-29
2.3	Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.	29-31
2.4	Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).	31-51

2.5	Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;	51-53
2.6	Auditimi mbi procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IKMT-ja. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.	53-54
3.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	54
3.1	Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.	54
3.2	Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.	54-60
3.3	Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.	60-71
3.4	Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës	74-82
4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	82
4.1	Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.	82-83
4.2	Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.	83
4.3	Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	83-90
5.	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	-
IV.	REKOMANDIME	90-100

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Pustec si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilit janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatore.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Pustec për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet auditimeve, synohet përdorimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet i fondeve publike, pronës publike

dhe asaj shtetërore, zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij, duke rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

-Për vitin 2023 Bashkia Pustec nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 15,617 mijë lekë.

-Për vitin 20223 nga Bashkia Pustec janë shpenzuar gjithsej 441,742 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 60,093 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 16,454 mijë lekë; për ndihma ekonomike dhe invaliditeti në vlerën 16,513 mijë lekë; për investime në vlerën 348,485 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Pustec për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është një vlerësim i pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e bashkisë, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

- Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur një opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023.

-Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike. (Aseteve dhe pyje kullota) të transferuara sipas VKM.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u

fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 8,831 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore. .

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Pustec për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe janë lënë 19 rekomandime.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë

- Nga Sektori i Financës janë kryer veprime apo mosveprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:
- Me përfundimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara në vlerën 2,196,820.39 lekë, nga ana e SFB në hartimin e pasqyrave financiare nuk është bërë shkarkimi nga kontabiliteti i tyre në llogaritë përkatëse;
- Llog.470 “të ardhura për tu marrë” është nënvlerësuar për vlerën e llogarisë kundërparti - llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 22,486,478 lekë;
- Mos pasqyrim të vlerës së aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në rubrikën "pakësime" të pasqyrave Format 7/a e 7/b për shumën 2,196,820.39 lekë;
- Llog. 26 “Aktivet Afatgjata Financiare”/“pjesëmarrje në kapitalin e vet” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat Format 1 e "pozicionit financiar" dhe Format 7/a e 7/b për vlerën 64,000 lekë;
- Llog. 218 “inventar ekonomik” është mbivlerësuar për shumën 12,650 lekë që përfshin 39 aktivet të cilat klasifikohen “fond biblioteke-libra” dhe i përkasin llog.212/nënlllog.2120 “krijim fond biblioteke” me koeficient amortizimi prej 5%, për të cilën llog.2120 “krijim fond biblioteke” është nënvlerësuar për të njëjtën vlerë 12,650 lekë.
- Bashkia Pustec (Sektori i Financës) nuk ka parashikuar dhe përlllogaritur në buxhet kostot e nevojshme për pagesa e tarifës për përgatitjen e plan rievimit për 148 pasuri pronë publike që duhen të dorëzohen pranë DV ASHK Korçë, për të bërë të mundur transferimin e pronës në pronësi të bashkisë Pustec me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin e kësaj Bashkie përcaktuar në prioritetet e investimeve dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në zbatim të pikës 1.2/a të nenit 9 dhe me piken 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

-Bashkia Pustec, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Koordinatori i MFK -së të merren masa për hartimin e një Kordi Etike, përditësimin e Rregullores së Bashkisë Pustec, duke përfshirë edhe Grupin për Menaxhimin Strategjik, miratimin e planit të punës, hartimit dhe miratimit të Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, hartimin e një plani vjetor trajnimesh për stafin dhe realizimin e këtyre trajnimeve

-Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

-Kryetari i Bashkisë Pustec të parashtojë tek Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore nevojën e bashkëpunimit për të rishikuar kuadrin ligjor lidhur me mundësinë e sigurimit të të ardhurave të NJVQV/Bashkive nga shfrytëzimi i resurseve ujore liqenore për të gjithë ata persona që nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë pajisur me leje për ushtrim aktiviteti të peshkimit pavarësisht llojit tregtar, shlodhës-argëtues apo atij studimor nga njëra anë, por dhe për një mirë menaxhim të këtyre burimeve në dobi të mjedisit dhe të cilësisë së jetës të komunitetit

-Në Bashkinë Pustec, GMS, Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i Financës në bashkëpunim me personin që ndjek çështjet juridike të marrin masa konkrete për zhblokimin e llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” veçanërisht për projekt investimet e hershme të trashëguara nga ish komunat.

-Nga Bashkia Pustec (Sektori i Financës dhe i Buxhetit) të parashikoj dhe të përlogarisë në buxhetin e ardhshëm kostot e nevojshme për përgatitjen e plan rievimit për 148 pasuri pronë publike që do të dorëzohen pranë DV ASHK Korçë, që kjo e fundit ti dërgoj për miratim në Këshillin e Ministrave

Bashkia Pustec në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me Agjencinë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të përcaktojnë dhe të saktësojnë pasuritë, për të bërë të mundur që Bashkia Pustec të ketë mundësi shfrytëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës.

1.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e Subjektit:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pustec për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka

përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinion me rezervë”- (SNA 705), pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të njësisë më 31.12.2023, referuar ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin:

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë SNA 700.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Subjektit. Për këto arsye kemi dhënë opinion me rezervë¹, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Llog.470 “të ardhura për tu marrë” është nënvlerësuar për vlerën e llogarisë kundërparti - llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 22,486,478 lekë;

Mos pasqyrim të vlerës së aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në rubrikën "pakësime" të pasqyrave Format 7/a e 7/b për shumën 2,196,820.39 lekë;

- Llog. 26 “Aktivet Afatgjata Financiare”/“pjesëmarrje në kapitalin e vet” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat Format 1 e “pozicionit financiar” dhe Format 7/a e 7/b për vlerën 64,000 lekë;

- Llog. 218 “inventar ekonomik” është mbivlerësuar për shumën 12,650 lekë që përfshin 39 aktivet të cilat klasifikohen “fond biblioteke-libra” dhe i përkasin llog.212/nënlllog.2120 “krijim fond biblioteke” me koeficient amortizimi prej 5%, për të cilën llog.2120 “krijim fond biblioteke” është nënvlerësuar për të njëjtën vlerë 12,650 lekë.

¹ Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli VII, fq. 54, 56 dhe 60: “Një opinion i modifikuar me rezervë duhet të shprehet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 2705).

- Me përfundimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara në vlerën 2,196,820.39 lekë, nga ana e SFB në hartimin e pasqyrave financiare nuk është bërë shkarkimi nga kontabiliteti i tyre në llogaritë përkatëse;

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1343/1 prot., datë 13.11.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.11.2024 deri më datë 13.12.2024, në subjektin Bashkia Pustec për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. S.S. përgjegjës grupi;
2. S.J. auditues;
3. M.M. auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projektaporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Pustec.

2. Identifikimi i çështjes

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pustec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pustec.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë Pustec (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Përgjegjësi i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Pustec, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Pustec në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Pustec është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *“Për auditimin e brendshëm publik”*; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes Vendore”*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *“Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”*; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”* etj.; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”*.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 *“Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”* i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *“Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”*; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të*

drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 *"Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial"*, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore"* .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH"*, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 *"Për sistemin e taksave lokale"*, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"*, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006"* *"Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"*; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, *"Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"*, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë"*, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, *"Për pagat e vetëqeverisjes Vendore"*, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 *"Udhëzues të Auditimit Financiar"*; ISSAI 2300 *"Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare"*; INTOSAI GOV 9100 *"Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 *"Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm"*; INTOSAI *"Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"* etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashhtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmerinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

³ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumenti i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 *“Dokumentimi i Auditimit”*, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Gjatë hartimit të projekt raportit, sipas përcaktimeve ligjore nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti i audituar Bashkia Pustec, dërguar me shkresën nr. 216 prot., datë 13.02.2025 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1343/4 prot., datë 14.02.2025.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Pustec”.

Auditimi në Bashkinë Pustec u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Bashkia Pustec është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pustec.

Bashkia e Pustecit bën pjesë në rrethin dhe qarkun e Korçës dhe ndodhet në skajin verilindor të Qarkut. Bashkia kufizohet në perëndim me bashkitë Pogradec dhe Maliq, në veri dhe lindje me

Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jugperëndim me Bashkinë Maliq në jug me Bashkinë Devoll dhe në lindje me Greqinë.

Kryeqendra e bashkisë së re është fshati i Pustecit, i cili ndodhet 25 km larg nga qyteti i Korçës. Bashkia e re e Pustecit përbëhet nga një njësi administrative. Kjo për shkak se reforma territoriale aplikoi kritere të veçanta që lidhen me shumicën e popullsisë etnike që jeton në territorin e bashkisë. Përndryshe, Bashkia e re e Pustecit është ish komuna Liqenas, emër zyrtar që u përdor në periudhën kohore 1973-2013.

Bashkia ka nën administrimin e saj 9 fshatra, të cilat janë: Pustec, Shulin, Leska, Zarashka, Cerje, Goricë e Madhe, Goricë e Vogël, Diellas, Gollomboc, të cilat shtrihen në një gjatësi prej 45 km. Territori i bashkisë shtrihet në një sipërfaqe prej 1363.8 ha..

Kjo bashki popullohet nga minoriteti etnik maqedonas të cilët janë të integruar në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Gjithashtu, popullata lokale karakterizohet nga ndërveprime sociale, kulturore dhe ekonomike intensive me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Popullsia e bashkisë arrin në 3,290 banorë (Census 2023), Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, popullsia raportohet të jetë 5,345 banorë (1421 familje).

Territori i bashkisë përkon me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës, i cili ka statusin e Parkut Kombëtar të Prespës, zonë e mbrojtur në nivel ndërkombëtar.

Bashkia Pustec si njësi vendore kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit.

1. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”.

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

-Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

-Bashkia Pustec përgjatë për vitin 2023, ka ushtruar funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “Për organizimin, funksionimin, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Pustec”, miratuar me Vendimin nr.18, datë 28.02.2023 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pustec. Hartimi dhe miratimi i kësaj rregullore është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9. Etika në Bashkinë Pustec trajtohet në nenin 12 dhe 13 të Rregullores së Bashkisë, por nuk ka gjetur një trajtim të gjerë brenda kësaj Rregulloreje ose me

anë të një dokumenti të vecantë miratuar nga Këshilli Bashkiak, duke ardhur në kundërshtim me përcaktimet e Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3, ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga përgjegjësit sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

Në lidhje me parimin nr 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

-Për vitin 2023, Bashkia Pustec nuk ka hartuar dhe miratuar plan-veprimin për kontrollin e brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.3.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Nga auditimi rezulton se lidhur me strukturën organizative, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Pustec ka miratuar strukturën organizative për vitin 2023 me VKB nr. 63, datë 28.12.2022. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën me nr. 1160/1 prot., më datë 09.01.2023.

-Bashkia Pustec ka gjithsej 92 punonjës, ndër të cilët: 39 janë punonjës të Administratës së Bashkisë, 30 punonjës pjesë e strukturës së Agjencisë së Shërbimit Publik, 8 punonjës pjesë e strukturës për arsimin parashkollor, 14 punonjës pjesë e strukturës së Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi si dhe 1 punonjës specialist i gjendjes civile (funksion i deleguar).

-Për vitin 2023 janë kryer vlerësimet periodike për punonjësit me status nëpunësi civil.

-Për vitin 2023 janë rekrutuar dhe larguar nga puna punonjësit si më poshtë.

LISTA ME EMRAT E PUNONJESVE TË PUNËSUAR PËR VITIN 2023

Nr.	Emër Mbiemër	Profesioni	Vite pune
1	T.T.	Specialiste e ndihmë ekonomike	----
2	S. I.	Topograf	----
3	F.J.	Ciceron	2
4	G.A.	Punonjëse e Tatim Taksave	----
5	S.V.	Punonjëse e Gjendjes Civile	----
6	V.S.	Specialiste Mjedisi	2
7	A.P.	Nënkryetar	---
8	A.M.	Sekretar i Kryetarit	---

9	A.P.	Jurist	Mbi 25
---	------	--------	--------

LISTA ME EMRAT E PUNONJËSVE TË LARGUAR PËR VITIN 2023

Nr.	Emër Mbiemër	Profesioni	Vite pune në administratën Publike
1	L.M.	Jurist	3
2	P. D.	Topograf	24
3	L.K.	Specialiste PAK	-
4	S.M.	Ciceron	4
5	S. T.	Specialiste për BE	25
6	A. M.	One Stop Shop	4
7	E.M.	Specialist për Marrëdhënien me Publikun	1

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

-Nuk janë miratuar planet vjetore të punës.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Për vitin 2023 nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pustec nuk ka hartuar planin vjetor të trajnimeve në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1.

-Për Bashkinë Pustec Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, z. P. K., i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Për vitin 2023, detyra e nëpunësit zbatues është mbuluar nga Përgjegjësi i Sektorit të Financave, z. C. N., i cili ka arsimimin e duhur për ushtrimin e kësaj detyre në përputhje me përcaktimet e ligjit.

-Me Urdhërin me nr. 21/1 të datës 17.01.2023, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorit të Riskut, z. A. P. me detyrë nënkryetar bashkie.

-Me Urdhërin me nr. 490, prot, 04.04.2023, Kryetari i Bashkisë Pustec ka ngritur Ekipin për Menaxhimin e Programit me drejtuesz. P.P. dhe përbërje përgjegjësit e sektorit të administratës: S. T, Q. Th. V. A.

-Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Me shkresën me nr. 489 prot, datë 03.04.2023, Kryetari i Bashkisë Pustec ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik me përbërje: z. J. A. me detyrë nënkryetar i Bashkisë Pustec, z. C. N., me detyrë përgjegjës i sektorit të financës dhe z. V.S., me detyrë përgjegjës prokurimesh. Nuk dokumentohet realizimi i takimeve të GMS përgjatë vitit 2023, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualin për MFK” ku citohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe nëpërputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet

të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27; “Manuali MFK” Kreu II kap. 2.2.6.

II.Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Bashkia Pustec ka miratuar strategjinë për menaxhimin e riskut për vitet 2023-2025.

-Për vitin 2023, Bashkia Pustec ka miratuar regjistrin e riskut.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Bashkia Pustec ka miratuar strategjinë për menaxhimin e riskut për vitet 2023-2025.

-Për vitin 2023, Bashkia Pustec ka miratuar regjistrin e riskut.

-Në Bashkinë Pustec Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

-Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Pustec, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Pustec nuk ka hartuar Planin për Kontrollin e Brendshëm dhe Regjistrin e Riskut për vitin 2023 në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.

III.Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut.

-Nuk është miratuar harta e proceseve të punës..

-Me shkresën nr. 382, prot., 10.03.2024 datë 10.03.2022, Bashkia Pustec ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit. Me shkresën me nr. 383 prot., datë 10.03.2022, Bashkia Pustec ka miratuar Rregulloren për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit Për Mbrojtjen nga Hakmarrja në Bashkinë Pustec.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave

financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Pustec.

-Bashkia Pustec në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Pustec, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Bashkia Pustec ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://ëëë.bashkiaPustec.gov.al/> Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor. -Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

-Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Bashkia Pustec lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemit për vitin 2023 me shkresën me nr. Prot. 268/1 datë 20.02.2024. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet problematikat në 5 komponentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Në zbatim të nënpikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

-Nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Pustec, konstatohet se për vitin 2023 nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm, veprim në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe pikën 1, të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Në këto kushte rezulton se aktiviteti ekonomik dhe financiar i këtij institucioni nuk është audituar nga struktura të auditit të brendshëm. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësiti e menaxhimit të Bashkisë Pustec, u konstatua se kjo njësi vendore ka lidhur me shkresën me nr. 1326 prot, datë 10.10.2023 një Akt Marrëveshje me palë Bashkinë Devoll, për realizimin e auditimit të brendshëm në Bashkinë Pustec. Pavarësisht lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Devoll, për vitin 2023 nuk është kryer

auditim mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare në Bashkinë Pustec, duke pasur në konsideratë faktin se kjo marrëveshje është lidhur dy muaj përpara mbarimit të vitit ushtrimor 2023.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

➤ Struktura organizative e Sektorit të Financës dhe Buxhetit për vitin 2023 Bashkia Pustec:

Nr	Emërtimi i pozicionit në strukturë	Emër Mbiemër	Formimi arsimor	Numri i punonjësve/Periodha e ushtrimit të detyrës
1	Përgjegjës	C.N.	Financë/MSH	1993 e në vijim
2	Specialist Finance & Asete	M.J.	-/-	2022 e në vijim
3	Specialiste finance	D.S.	Ekonomi/B	2016 e në vijim
4	-/-	P. P.	Financë/MP	2020 e në vijim
5	Magaznier	S.J.	Mesme Ushtarake	2021 e në vijim
Numri total i punonjësve në strukturë			5	

Burimi: SFB/Bashkia Pustec

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 62 datë 03.04.2023 me nr. 489 prot., datë 03.04.2023 dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) me Urdhrin nr. 63 datë 03.04.2023 me nr. 490 prot., datë 03.04.2023 të Titullarit të institucionit. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2023-2025, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2023 sipas funksioneve/nën funksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuar nga Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pasqyrohen në tabelën nr.1/Aneksin B1.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, pasqyruar në Aneksin B1, rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MFE për përgatitjen e PBA 2023-2025 nga SFB /Bashkia Pustec janë planifikuar për buxhetim vetëm 8 programe; dhe ka funksione/nën funksione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” (neni 23); “Transportin publik vendor” dhe “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”; F- “në fushën e mbrojtjes së mjedisit” (neni 26); N/f-“Ngritja dhe funksionimi i tregjeve” etj; N/f- “Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi”, “Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi” etj; Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nën funksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon bashkia Pustec.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar për çdo program, sipas PBA (shpërndarja e fondeve sipas programeve), është paraqitur në tabelën nr. 2/Aneksin B2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin B2, rezultoi se:

- Në PBA 2023-2025, planifikimi i fondeve në buxhet në total ka ardhur në rritje nga viti në vit: me 2,438 mijë lekë nga 2023 në vitin 2024 dhe me 2,627 mijë lekë nga viti 2024 në vitin 2025;
- Nga 8 programe të buxhetuara në PBA 2023-2025, 6 prej tyre janë planifikuar në të njëjtën vlerë për të tre vitet e PBA-së dhe vetëm 2 prej tyre janë planifikuar me vlera në rritje të cilat kanë diktuar dhe trendin e vlerës totale të çdo viti të PBA 2023-2025;
- Programi 0111 ka rritje të vlerës së planifikuar, pasi në të përfshihet edhe programi 03140;
 - Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Pustec për buxhetin e vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, krahasuar me programet e miratuara nga MFE për tu patur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2023-2025, pasqyrohen në tabelën 3 /Aneksi B3:

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetuar	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2023	
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit			Plan	Fakt
1	011	01110	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	441,434	393,732
3	031	03140		Shërbimet e Policisë Vendore		
	032	03280	03280	MZSH	36,806	15,454
	041	04130		Mbështetje për zhvillim ekonomik		
4	042	04220		Shërbimet bujqësore/inspektimi /siguria ushqimore/mbrojtja konsumatore		
		04240	04240	Kullim-Ujitja	10,610	4,250
		04260	04260	Pyje-Kullota	2,414	1,196
	045	04520	04520	Rruge Rurale	2,784	1,720
		04570		Transporti Publik		
			04980	Fond kontigjence, Fond rezervë	940 770	677 0
5	051	05100	05100	Mbetje Urbane		
6	061	06140		Planifikimi urban vendor		
	062	06260	06260	Shërbime Publike		
	063	06370		Furnizim me ujë dhe kanalizime		
7	072	07220		Shërbimet e kujdesit parësor		
8	081	08130		Sport dhe argëtim, turizëm;		
	082	08220	08220	Shërbime kulturore		
9	091	09120	09120	Arsimi bazë/parashkollor	16,708	8,970
	092	09230	09230	Arsimi i Mesem		
10	104	10430	10430	Paaftësi/ Kujdesi Social/ndihma ekonomike	16,976	16,420
	106	10661	10661	Strehimi Social		
	109	10910	10910	Mbrojtje Civile Emergjence	69,340 823	39,919 0
22 Programe			9 Programe		527,732	441,742

Burimi: Bashkia Pustec/Punoi: Grupi i auditimit

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të

vitit 2018”, Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1 si dhe VKB nr. 98 datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Pustecit për vitin 2023”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e funksioneve të bashkisë dhe programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MFE, *rezultoi se*: fondet e buxhetuara për “policinë vendore” nuk janë përfshirë në programin përkatës 03140 – “shërbimet e policisë vendore”, fondet për drejtorinë e shërbimit urban dhe e shërbimeve publike ku përfshihet dhe IMTV nuk janë përfshirë në programin përkatës 06140 – “Planifikimi urban vendor”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1.

Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, është paraqitur në *Aneksin B4*, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *Aneksin B4*, *rezulton se*:

- Nga planifikimi i fondeve në PBA 2023-2025, zëri "paga" ka vlerën më të lartë për të 3 vitet, vlerë e cila vjen në rritje nga viti në vit, ose në masën 57% në vitin 2023, 58% në vitet 2024 e 2025;
- Zëri "shpenzime operative", ndonëse vlera e planifikimit të tij në PBA vjen në rënie mbetet zëri pas pagave me planifikimin buxhetor më të lartë ose në masën 26% në vitin 2023, 25% për vitet 2024 e 2025;
- Vlera e zërave "603,604,606 dhe 609" ka të njëjtat nivele për të 3 vitet e PBA, dhe zënë nga 0 deri në 2% të totalit të buxhetit të planifikuar.

Tendenca e të ardhurave sipas PBA 2023-2025, është paraqitur në *Aneksin B5*, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr. 5/Aneksi B5*, *rezulton se* të ardhurat e veta janë planifikuar për çdo vit të PBA 2023-2025 në të njëjtat vlera. Grupi i auditimit duke analizuar këtë fakt, arrin në konkluzionin se kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së një analize të mirëfilltë të realizimit apo mosrealizimit të çdo takse e tarife vendore. Për vitin 2023, struktura organizative është miratuar me VKB nr. 62, datë 28.12.2022. Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 59 prot., datë 12.01.2023, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 01.03.2023.

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Pustec për PBA 2023-2024 dhe Projekt buxhetin e vitit 2023, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2023-2024 dhe Projekt buxheti vjetor 2023 nga ana e bashkisë Pustec është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun;

Tabela 1

Datat	PBA 2023-2025	P.Buxheti 2023
	27.09.2022	27.09.2022
Numri i takimeve	1	1

Procesi konsultativ me komunitetin realizohet nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, ëeb-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., konform ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të njësive të strukturës (sektorëve) së Bashkisë Pustec, drejtorive të shkollave, kopshteve, etj.

- Hartimi i PBA 2023-2025 rezulton të ketë kaluar të gjitha fazat e përgatitjes, konform kuadrit ligjor

- PBA 2023-2025 dhe Buxheti vjetor për vitin 2023 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

Tabela 3

Nr.	PBA 2023-2025	P. Buxheti 2023
1.	Nr.60 dt.28.12.2022	VKB Nr. 61 dt. 28.12.2022
2.		Urdhri nr.11 dt. 10.01.2023
3.		VKB nr. 17 datë 28.02.2023
4.		Urdhri nr.53 dt. 20.03.2023
5.		VKB nr. 25 datë 26.04.2023
6.		VKB nr. 26 datë 26.04.2023
7.		Urdhri nr.82 dt. 04.05.2023
8.		Urdhri nr.97 dt. 05.06.2023
9.		VKB nr. 43 datë 29.06.2023
10.		VKB nr. 44 datë 29.06.2023
11.		VKB nr. 59 dt. 12.01.2023
	1	10

Shpërndarja e fondeve të trashëguara nga 2022

Burimi: SFB/ Bashkia Pustec

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelën 3, rezulton se buxheti vjetor 2023 ka pësuar 10 ndryshime: 6 ndryshime janë miratuar me VKB dhe 3 ndryshime për transferim fondi brenda të njëjtit program me Urdhër të titullarit të njësisë. Për këto ndryshime, është zbatuar kuadri ligjor në fuqi për buxhetin.

- Një informacion i detajuar mbi vlerën e fondeve të transferuara, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4/Në lekë

Buxheti fillestar 2023	Ndryshimet në Buxhet gjatë vitit 2023					
Vlerë	Art. Nr. datë	vlerë	Shtesa/art	shuma	Pakësuar/art	shuma
83,281,308	Urdhri nr.11 dt. 10.01.2023	20,000	606	20,000	601	20,000
	Urdhri nr.53 dt. 20.03.2023	50,000	606	50,000	600	50,000
	VKB nr. 25 datë 26.04.2023	92,000	602	92,000	231	92,000
	VKB nr. 26 datë 26.04.2023	800,000	231	800,000	230	230,000
					231	570,000
	Urdhri nr.82 dt. 04.05.2023	50,000	606	50,000	600	50,000
	Urdhri nr.97 dt. 05.06.2023	300,000	601	300,000	600	300,000
		100,000	231	1,050,000	602	100,000
	Urdhri nr. 43 dt. 29.06.2023	950,000				950,000
	Urdhri nr 44 dt. 29.06.2023	1,200,000	231	1,400,000	230	1,100,000
		200,000				300,000

Burimi: SFB/ Bashkia Pustec

a. Bashkia Pustec ka hartuar e miratuar “Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor” për Bashkinë Pustec dhe njësisë të varësisë/administrative për vitin 2023, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

b. PBA 2023-2025 dhe Plan i vjetor i buxhetit për vitin 2023, janë miratuar me VKB nr. 60 dhe VKB nr. 61, datë 28.12.2022 ; Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2023, ka pësuar gjashtë (6) ndryshime, të cilat janë miratuar sipas VKB për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh të trashëguara nga viti paraardhës 2022, për tu përdorur në buxhetin e vitit 2023, të pasqyruara në tabelat e mësipërme nr. 3 dhe nr. 4.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

c. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Planit vjetor 2023 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime. VKB janë regjistruar në librin e protokollit të Bashkisë Pustec

d. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Korçë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Korçë.

- Planifikimet fillestare sipas PBA-së dhe planit vjetor 2023⁴, pasqyrohen në tabelën nr. 6/ Aneks B6. Referuar të dhënave të pasqyrës, *konstatohet se* Bashkia Pustec ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 6.5% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e veta të trashëguara nga viti paraardhës janë 5,230 mijë lekë. Të ardhurat e veta në total për vitin 2023 janë 13,230 mijë lekë ose në masën 10.8% të planit fillestar vjetor të miratuar.

- Ndërsa shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në Bashkinë Pustec për Planin e buxhetit të vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, pasqyrohen si në tabelën nr. 7 /Aneks B7. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në Aneksin B7, *konstatohet se:*

realizimin më të lartë ndaj planifikimit e ka zëri “transferta korrente & transferta buxhete & fond rezervë” me 93.1% dhe atë më të ulët e ka zëri "shpenzime operative" me 39.2%;

realizimin më të lartë ndaj totalit të buxhetit e ka zëri "investime" me 72.8% dhe atë më të ulët e ka zëri “transferta korrente& transferta buxhete familj& fond rezervë” me 30.7%.

- Sipas burimit të financimit planifikimi të dhënat janë pasqyruar në tabelën nr. 8/ Aneks B8 Nga verifikimi dhe të dhënat e pasqyruara në Aneksin B8 rezultoi se shpenzimet me burim të “ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar: për vitin 2023 në vlerën totale 10,270 mijë lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 4,484 mijë lekë ose 43.7% e tyre;

⁴ Informacion i plotë mbi PBA 2023-2025 pasqyrohet në Tabelën nr. 4/ B4

Nga fondet "e pakushtëzuara" janë planifikuar 435,364 mijë lekë dhe shpenzuar 391,875 mijë lekë ose 90% e tyre;

Si dhe nga fondet "specifike e sektoriale" janë planifikuar 82,098 mijë lekë dhe shpenzuar 45,383 mijë lekë ose 55.3% e tyre.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezultoi se të ardhurat për shpenzime të planifikuara bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2022 janë 527,732 mijë lekë.

Ndërsa buxheti fillestar për vitin 2023 është planifikuar në vlerën e 122,595 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2022 prej 39,314 mijë lekë (nga të ardhurat e veta & transfertat e pakushtëzuara + tr.specifike e sektoriale) dhe transfertat shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 527,732 mijë lekë. Krahasuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 405,137 mijë lekë më shumë se ai fillestar dhe realizimi i tij në vlerën e 441,742 mijë lekë.

- Për sa i përket shpenzimeve referuar tabelës nr. 7/Aneksi B7, nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 15.6% ose në vlerën 82,294 mijë lekë, shpenzimet korrente zënë 11.6% ose për vlerën 61,396 mijë lekë dhe shpenzimet për investime zënë 72.8% ose në vlerën 384,042 mijë lekë.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Pustec për vitin 2023 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa "dh" të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Pustec.

- Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar me VKB nr. 62, datë 28.12.2022, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 59 Prot., datë 12.01.2023, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 01.03.2023. Informacion i detajuar mbi numrin e punonjësve pasqyrohet në Tabelën nr. 9/ Aneksi B9, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 62, datë 28.12.2022, në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjit nr. 7961/1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, VKM nr. 627, datë 28.09.2022 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.04.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 604, datë 14.09.2022 "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 465, datë 06.07.2022 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.03.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversita", i ndryshuar, VKM nr. 624, datë 28.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", VKM nr. 625, datë 28.9.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të këshillit të ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të

funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, etj.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës. Informacion i detajuar mbi planifikimin, çeljet dhe ndryshimet e bëra gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 në buxhetin e vitit 2023 të miratuar, janë pasqyruar më lart në tabelën 2 dhe tabelën 3 të Raportit të Auditimit.

- Nga analiza e vlerave në pasqyrat e mësipërme, vërehet se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Pustec nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe si: 04570- “Transporti publik”, 04130- “Mbështetje e zhvillimit ekonomik”, 07220- “Kujdesi Parësor Shëndetësor” dhe 042/20- “Shërbimi, inspektimi i tregjeve dhe mbrojtja e konsumatorit”, 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor”, 062/1 “programe zhvillimi”, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Pustec nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë.

Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale

- Bashkia Pustec nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin e fondeve në buxhet për t'i kushtuar rëndësi programit 042 “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me 051-“Menaxhimi i mbetjeve”; 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 041-“Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” etj, të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritare nga bashkia Pustec. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

- Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjatë vitit 2023 nuk është bërë raportimi periodik shkresor 4 mujor dhe 8 (vetëm elektronik) dhe 12 mujor (zyrtar shkresor dhe elektronik) i realizimit të buxhetit në MFE.⁵

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktura sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2023 rezultoi se PBA 2023-2025 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Pustec ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2023 në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

Për sa më sipër, një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën më poshtë dhe i detajuar pasqyrohet në Tabelën nr. 10/ Aneks B10


Tabela nr. 4/në mijë lekë

Bashkia Pustec. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar. Viti 2023.									
Art	Emertimi	(1) Fakti i vitit para ardhës Viti 2022	(2) PBA Plan Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB .61 dt.28./12./2022)	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Çelja në thesar	(6) Fakti i 12- mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
Totali (korrente + kapitale)		150,202		122,595	527,732	521,625	441,743	(-)79,882	84.7%

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar, janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak ose të diktura nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore.

⁵ Informacioni i detajuar pasqyrohet mëposhtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit



- Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar akt rakordimeve me thesarin është paraqitur në *Aneksin B11/Tabela nr.11*, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Referuar të dhënave të pasqyruara në *Aneksin B11*, rezulton se niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 39.2% deri në 93.1% për vitin 2023;
- llog. 606 “transferime për buxhetet familjare dhe individë” ka realizimin më të lartë në masën 93.1% dhe llog.602 “shpenzime operative” ka mosrealizimin më të lartë në masën 39.2%;
- Duke e krahasuar me vitin paraardhës 2022, një informacion të shpërndarjes dhe të realizimit të buxheteve respektive për çdo zë buxhetor, pasqyrohet në *tabelën nr.12/ Aneks B12*, dhe në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr. 5:

Tabela nr. 5/në mijë lekë

Artikulli	2022			2023		
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.
Totali	195,110	150,202	(-)45,142	527,732	441,742	(-)86,128
Diferenca plan (2023-2022)	332,622					
Diferenca fakt (2023-2022)	291,540					
Trendi i realizimit vjetor	77%			83.7%		Dif. 6.7% ↗

Punoi Grupi i Auditimit

Nga informacioni i pasqyruar në *Aneksin B12*, rezulton se:

- Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me një diferencë prej 332,622 mijë lekë;
- Niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rritje nga viti 2022 në vitin 2023, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pustec dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.
- Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2023 e zënë llog.230 e 231 – “Investimet” me 384,042 mijë lekë ose 72.8% e totalit të buxhetit, e ndjekur nga llog.600 “paga” me 70,269 mijë lekë ose 13.3% të totalit të buxhetit; ndërsa në vlerat më të vogla janë llog. 609 “rezervat” me 770 mijë lekë ose 0.15%.

Sipas burimeve të financimit:

Për përdorimin e të ardhurave treguesit e buxhetit për vitin 2023, sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, janë planifikuar** si në tabelën 13 të *Aneksit B13*, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

- Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta**, treguesit e buxhetit janë planifikuar si më poshtë:

Tabela nr.6/në lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			%
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura te veta	të ardhura të veta ndaj totalit
TOTALI		527,732,413	62,300,411	452,201,760.00	13,230,242	2.5
në %		100	11.8	85.7	2.5	

Burimi: Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *Aneksin B13* rezulton se nga shpërndarja e fondeve sipas burimit të financimit në planifikimi, volumin më të lartë të tyre e zë “transferta specifike/sectoriale” në masën 85.7% ndaj buxhetit total ose në vlerën 452,201,760 lekë, me 11.8% ndaj buxhetit total ose në vlerën 62,300,411 le zën fondet nga “transferta e pakushtëzuar” dhe peshën më të vogël në masën 2.5% ndaj buxhetit total ose në vlerën 13,230,242 lekë e zën fondet nga “të ardhurat e veta”;

Nga “të ardhurat e veta” sipas zërave buxhetorë, peshën më të madhe e zënë “pagat” në masën 61.2% ndaj totalit të të ardhurave të veta ose në vlerën 8,100,000 lekë dhe peshën më të vogël “transferta buxhete familjare/individë” në masën 1.5% ndaj buxhetit total të të ardhurave të veta ose në vlerën 200,000 lekë.

- Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta**, treguesit e buxhetit janë realizuar si më poshtë:

Tabela nr. 7/në lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			% nga të ardhurat e veta ndaj totalit
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura te veta	
TOTALI		441,545,625	38,340,198	397,501,565	5,703,862	1.3
në %		100	8.7	90	1.3	

Burimi: Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *Aneksin B14* -realizimi i buxhetit sipas burimit të financimit, *rezulton se* realizimin më të lartë e kanë “transferta specifike/sectoriale” në masën 90% ndaj buxhetit total ose në vlerën 397,501,565 lekë ku zëri “investime” zë 86.3% të fondit të akorduar; me 8.7% ndaj buxhetit total ose në vlerën 38,340,198 lekë nga “transferta e pakushtëzuar” ku zëri “paga” zë 73.3% të fondit të akorduar dhe vlerën më të vogël në masën 1.3% ndaj buxhetit total ose në vlerën 5,703,862 lekë nga “të ardhurat e veta” ku zëri “paga” zë 74.3% të fondit të akorduar;

Nga “të ardhurat e veta” sipas zërave buxhetorë, realizimin me vlerë më të madhe kanë “pagat” në masën 74.3% ndaj totalit të të ardhurave të veta ose në vlerën 4,236,950 lekë dhe vlerën më të vogël “transferta buxhete familjare/individë” në masën 1.6% ndaj buxhetit total të të ardhurave të veta ose në vlerën 93,060 lekë.

Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore

Nga auditimi rezulton se realizimi i Buxhetit është: për vitin 2022 është 150,202 mijë lekë; për vitin 2023 buxheti faktik është në vlerën e 441,752 mijë lekë ose 291,540 mijë lekë më shumë se vitit 2022; dhe se buxheti faktik ndaj atij të planifikuar (progresivit), është në masën 83.7% të tij, duke rezultuar në vlerë më të lartë se realizimi i vitit 2022.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Trendi
1	Shpenzimet e planifikuara	195,110	527,732	
2	Shpenzimet faktike	150,202	441,742	

Burimi: Bashkia Pustec/Punoi: Grupi i auditimit

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 12,13 dhe 14/Aneks B dhe përmbledhur në tabelat nr. 5, 6 dhe 7, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie dhe në mënyrë të përmbledhur paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në mijë lekë

Emërtimi	2022	2023		Vlera e mosrealizimit	
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca	Trendi
Shpenzime	150,202	527,732	441,742	291,540	
Të Ardhura	190,699	527,732	521,625	330,926	

Burimi: Bashkia Pustec/Punoi: Grupi i auditimit

- Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Pustec ka patur financime të huaja nga Ambasada Japoneze për vitin 2023;

Në mijë lekë

Kodi projektit	Emërtimi projektit	Vlera e plote	Viti i fillimit	Viti perfundimit	Buxheti 2023	Plani i buxhetit 2023	Realizimi progresiv nga fillimi deri periudha aktuale	Realizimi per periudhen raportuese vjetore 2023	Realizimi progresiv nga fillimi deri periudha aktuale	komete
	Rikonstruksion rruga hyrëse tek muzeu	158,736						158,736	158,736	proçes
Drejtues i EMP				Kryetari i Bashkisë				Raportimi Maj 2024		

Burimi: Bashkia Pustec

- Bashkia Pustec nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2023 (as në periudhat paraardhëse);

- Bashkia Pustec nuk ka patur subvencione nga shteti;

Një pasqyrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, rezulton se vlera e të ardhurave dhe e shpenzimeve ka trend në rritje nga viti në vit, gjë e cila tregon se planifikimi bazohet në kërkesat reale të nevojave që ka njësia publike.

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Trendi
1	Të ardhurat faktike	190,699	521,625	
2	Shpenzimet faktike	150,202	441,742	

Burimi: Bashkia Pustec

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi në Këshillin Bashkiak:

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se nga SFB janë bërë raportimet 4, 8 mujore vetëm në rrugë elektronike; vetëm raportimi 12 mujor është bërë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas formateve të përcaktuara nga MFE: me shkresën nr. 745 prot., datë 06.06.2024 Raportimi 12 mujor. *Rezulton* se ky raportim është dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në tejkallim të afatit ligjor;

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raporti i Monitorimit të buxhetit të vitit 2023 është miratuar është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar Fondi Rezervë [FR], Fondi kontigjencës [FK], Fondi i Emergjencës [FE] dhe Mbrojtja civile [MC] (nga AKMC), vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2023	Fakt 2023	
Fond Rezervë	770	0	
Fond Emergjence	823	0	
Fond Kontigjence	940	677	
Mbrojtja Civile	69,340	39,919	
Totali	71,873	40,596	Diferenca 31,277

Burimi: SFB/Bashkia Pustec

Përdorimi i këtyre fondeve realizohet me miratimin e Këshillit Bashkiak. Me VKB nr. 60 datë 28.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” *rezulton* se në buxhetin vjetor të vitit 2023 vlera e tyre e planifikuar [Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës] është në vlerën totale 1,710 mijë lekë ose në masën 1.4% të vlerës totale të buxhetit fillestar të miratuar në mospërputhje me ligjin nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 823 mijë lekë dhe përfaqëson fondet që bashkia planifikon nga të ardhurat e veta në rastet e fatkeqësive natyrore, të cilat për vitin 2023 nuk janë shpenzuar;

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile/mbrojtja civile:

Referuar kriterëve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga sa më lart, nga auditimi *rezulton* se Bashkia Pustec për vitin 2023 fondin për mbrojtjen civile e ka planifikuar në vlerën e 69,340 mijë lekë nga i cili ka shpenzuar 39,919 mijë lekë dhe vlera prej 29,421 mijë lekë është trashëguar për vitin pasardhës. Ndërsa nga të ardhurat e veta “fondi i emergjencës” është planifikuar në vlerën 823 mijë lekë. Në total fondet për emergjencat

civile për vitin 2023 janë planifikuar në vlerën 70,163 mijë lekë. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1.

Realizimi i Investimeve:

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2022 dhe 2023 për bashkinë Pustec, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara", pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Në lekë

230-231	2022	2023			
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca ndaj planifikimit	Diferenca ndaj faktit
	65,820,000	384,041,996	348,485,592	(-)35,556,404	282,665,592

Burimi: Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë *rezulton se* mosrealizimi i fondit të planifikuar për “investimet” është në vlerën (-)35,556 mijë lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2022 shpenzimi i fondeve për këtë zë ka ardhur në rritje me 282,665 mijë lekë, që tregon jo vetëm për numrin e lartë të investimeve por edhe për nevojat reale të bashkisë.

Duke iu referuar të dhënave në tabelën e mëposhtme të të ardhurave të vet bashkisë Pustec, rezultoi si më poshtë vijon:

Në lekë

230-231	Burimet e Financimit	Viti 2023		%
		Plan	Fakt	
	Të ardhurat e veta	1,000,000	-	0
	Transferta specifike/sectoriale	373,066,243	342,968,534	92
	Transferta e pakushtëzuar	9,975,753	5,517,058	55.3
	Totali	384,041,996	348,485,592	90.7

Burimi: Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, *rezulton se* për vitin 2023 bashkia nuk ka arritur të shpenzojë fonde për “investime”, gjë që tregon se nuk ka mundur të arkëtojë nga taksat dhe tarifat vendore vlerën e planifikuar prej 1,000,000 lekë për zërin “investime”;

Konstatohet se mosrealizimi e buxhetit në arsyetimin e grupit të auditimit, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin e viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që të ardhurat veçanërisht të ardhurat e veta, kanë ardhur në rritje nga viti në vit, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

- Gjatë vitit 2023 ka patur këto investime, të cilat klasifikuar nga burimi i financimit, pasqyrohen në tabelën 15/Aneks B15

Nga informacioni i pasqyruar në Aneksin B15, *rezulton se*:

Investime me burim nga buxheti i shtetit janë 7 projekte investimi në vlerën totale 606,810 mijë lekë, nga të cilët deri në 31.12.2023 janë përfunduar 3 dhe 4 të tjera janë në proces;

Investime me burim nga të ardhurat e veta janë 4 projekte në vlerën totale 2,763 mijë lekë të cilat janë përfunduar.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për sa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Pustec gjatë vitit 2023 nuk ka patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre:

Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2023, është paraqitur në Aneks B16/ Tabela nr.16, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2023, është paraqitur në Aneksin B17/ Tabela nr. 17, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

2.2.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura.

Në PBA 2023-2025 dhe Planin vjetor 2023, Bashkia Pustec nuk ka planifikuar fonde me qëllim mos lënien jashtë buxhetimit të programit “likuidimi i detyrimeve të prapambetura”⁶.

▪ Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2023, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023	Total detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorëve 2023	Mbetja në fund të vitit 2023
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës	146,020,720	352,197,315	398,218,035	300,617,700	97,600,335
b. Investime nga Bashkia	24,265	4,866,763	4,891,028	4,775,743	115,285
Investime	146,044,985	357,064,078	403,109,063	305,393,443	97,715,620
Mallra dhe shërbime	696,633	849,839	1,546,472	849,839	696,633
Vendime gjyqësore	0	0			0
Të tjera ...	0	0			0
Totali	146,741,618	357,913,917	404,655,535	306,243,282	98,412,253

Burimi: SFB/Bashkia Pustec

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, *rezulton se:*

- Për zërin "investime" viti 2022 është mbyllur me vlerën totale të detyrimit të prapambetur prej 146,044,985 lekë, nga të cilat 146,020,720 lekë ose në masën 99.9% të tyre e zënë detyrimet nga ministritë e linjës dhe 24,265 lekë ose në masën 0.1% nga fondet e veta;

⁶ Sic është përmendur edhe më lart, në PBA 2023-2025, nuk është planifikuar fond në buxhet për programin detyrime të prapambetura.

Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 357,064,078 lekë, nga të cilat 352,197,315 lekë ose në masën 98.6% e zënë detyrimet e reja nga ministritë e linjës dhe 4,866,763 lekë ose në masën 1.4% detyrimet nga fondet e veta;

Gjatë vitit 2023 janë shlyer në total 305,393,443 lekë për detyrimet e prapambetura progresive që janë në vlerën 403,109,063 lekë, nga të cilat 300,617,700 lekë ose në masën 75.5% të tyre nga ministritë e linjës dhe 4,775,743 lekë ose në masën 97.6% nga fondet e veta;

Me mbylljen e vitit ushtrimor 2023, rezultojnë se vlera e mbetur e detyrimeve të prapambetura në total për zërin "investime" është në vlerën 97,715,620 lekë ose 48,329,365 lekë më pak se ai në mbyllje të vitit 2022, nga të cilat vlera prej 97,600,335 lekë detyrim nga ministritë e linjës ose në masën 99.9% të totalit dhe 115,285 lekë detyrim nga fondet e veta ose në masën 0.1% të totalit.

- Për zërin shpenzime /"mallra e shërbime" viti 2022 është mbyllur me vlerën e detyrimit të prapambetur prej 696,633 lekë;

Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 849,839 lekë, duke e ëuar vlerën totale progresive të detyrimit në 1,546,472 lekë;

Gjatë vitit 2023 janë shlyer detyrimi i krijuar në vitin 2023 prej 849,839 lekë, duke e mbyllur vitin ushtrimor 2023, vlerën e mbetur të detyrimeve të prapambetura për zërin "mallra e shërbime" 696,633 lekë me po të njëjtën vlerë sa edhe ai i vitit 2022;

- Për zërin shpenzime/"vendime gjyqësore" dhe "për shpronësime" nuk ka detyrime të prapambetura;

Konkluzion: Bashkia Pustec ka detyrime të prapambetura në mbyllje të vitit 2022 në vlerën totale progresive prej 146,741,618 lekë, nga të cilat 146,044,985 lekë për zërin "investime" ose në masën 99.5% të vlerës totale dhe për zërin "mallra e shërbime" në vlerën 696,633 lekë ose në masën 0.5% të vlerës totale progresive të detyrimeve;

Në mbyllje të vitit 2023 detyrimet e prapambetura janë në vlerën totale 98,412,253 lekë, nga të cilat për zërin "investime" në vlerën totale 97,815,620 lekë ose në masën 99.3% të totalit dhe në vlerën 696,633 lekë për zërin "mallra e shërbime" ose në masën 0.7% të vlerës totale progresive të detyrimeve.

Vlera e detyrimeve të prapambetura në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën totale progresive 98,412,253 lekë ose 48,329,365 lekë më pak se në mbyllje të vitit 2022.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike.

Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", pika 106, ku citohet:

"Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, "Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura" bashkëlidhur këtij udhëzimi."

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".

Konkluzion: Bashkia Pustec ka detyrime të mbartura nga viti 2023 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 për “investime” nga ministritë e linjës në shumën 97,600,335 lekë;

- Ka detyrime të mbartura nga viti 2023 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 për “Investime” nga të ardhurat e veta në shumën 115,285 lekë;
- Ka detyrime të mbartura nga viti 2023 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 për “mallra e shërbime” në shumën 696,633 lekë
- Nuk ka detyrime për vendime të proceseve gjyqësore për dëmshpërblim page, shpronësime etj.

Referuar Tabelës nr. 18 /Aneks B18(1),(2) “treguesit fiskalë të konsoliduar” dhe “situata e detyrimeve të prapambetura” vihet re se me udhëzimin e MFE, detyrimet nga fondet e ministrive të linjës, FZHR apo atyre të rindërtimit, nuk duhet të pasqyrohen tek tabela e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë, por veçmas si më poshtë:

Në lekë

Detyrime pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera ne leke
Ministri linje 06	2313300	97,600,335
FSHZH	-	0
Fonde nga Rindertimi	-	0

Burimi: Bashkia Pustec

Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore

Nga auditimi i PBA 2023-2024/Planit vjetor 2023, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar veçmas fondi në programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”. Nga auditimi i likuiditeteve rezulton se nuk kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2023, por janë trashëguar për vitin 2024 gjysma e vlerës totale të detyrimit të prapambetur mbartur nga viti 2022 për “mallra e shërbime”.

Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve

Në lekë

Nr.	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Diferencë (Fakt-Plan)	Shënime
	Bashkia Pustec	811,918	500,918	311,000	0	0	-

Burimi: Bashkia Pustec

SFB/Bashkia Pustec ka planifikuar që detyrimin e prapambetur të mbartur ta shpërndajë në shlyerje në 2 vitet pasardhëse: për 2024 në vlerën 500,918 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 311,000 lekë.

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësi e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
0,18% normale	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Pustec

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën më poshtë dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Pustec paraqet një situatë normale të vështirësisë financiare.

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	811,918		0.18%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	696,633		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	115,285		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	811,918	441,545,625	0.18%

Burimi: Bashkia Pustec

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar edhe të dhënave të MFE, rubrika “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në Aneksin B18/Tabela 18/19/20, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Raportet mbi detyrimet për vitin 2023 janë dërguar MFE si pjesë e Raporteve të Monitorimit 4, 8 dhe 12 mujor janë plotësuar sipas formateve të miratuara nga MFE dhe brenda afateve ligjore.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

I. Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 63, datë 28.12.2022 me nr. 1722/1 prot., datë 28.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës dhe Agjencisë së Bashkisë Pustec”. VKB e

miratimit të Paketës Fiskale 2023 është miratuar për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me nr. 1160/1 prot., datë 09.01.2023 konform përcaktimeve në kuadrin ligjor.

Si njësi përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Pustec, është edhe struktura e të Ardhurave Vendore e organizuar në nivel sektori/Sektori i Tatim Taksave, i cili është konfiguruar si në tabelën nr.1 e paraqitur në *Aneksin A1*. Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave, bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë pranë bashkisë, si: sektori i bujqësisë, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit [SBMTMK], Sektori i planifikimit urban [SPU], PMNZSH, Policia Bashkiake [PB], ASHP/ Administrimi i pyjeve etj, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, ndërsa roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim dhe gjobat e vendosura, dokument i cili i shërben taksapaguesve për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

- Sektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore/ Bashkia Pustec, për vitin 2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore. Nga auditimi *rezulton se* STTV ka në strukturën e tij 3 punonjës (1+2) ku një prej pozicioneve të inspektorëve ka qenë dhe vazhdon të jetë vakant, gjë që ndikon në performancën e aktivitetit të sektorit dhe në arritjen e objektivave institucionale.

Veç sektorit të tatimeve dhe taksave vendore, në Bashkinë Pustec janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, të miratuara me VKB e Paketës Fiskale 2023, sipas specifikave pasqyruar në *Aneks A2/ tabela nr. 2.*

Në fillim të çdo viti Sektori i Tatim Taksave bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të bashkisë, i cili është pjesë e Raportit vjetor të Monitorimit dhe e Raportit të buxhetit që prezantohet në Këshillin Bashkiak.

Paketa fiskale e përmbledhur pasqyrohet në *Aneks 3/ Tabela nr.3.*

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në këtë tabelë *rezulton se*:

- Bashkia Pustec në paketën fiskale 2023 me VKB ka miratuar 8 gruptaksash dhe 15 gruptarifash; 10 lloje Gjobash dhe 4 lloje TA jo tatimore;

- Afati fundor i pagesës së taksave dhe tarifave të vitit ushtrimor për biznesin është data 30.09 dhe për familjarët është data 30.06 e vitit ushtrimor.

- STTV Bashkia Pustec informacionin tatimor e përpunon në paketën *Microsoft Office 2013* - programi *excel*. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e STTV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

- Rezulton se nga ana e STTV çdo 3 muaj bëhen verifikime në terren, lidhur me veprimtarinë e subjekteve mbi hapësirën e lejuar publike dhe tabelën apo reklamën për të cilat paguan edhe tarifë të detyrueshme vjetore etj, shpërndan fletë njoftimet mbi detyrimet vjetore familjarëve dhe bizneseve. Për rastet e konstatimit të ndryshimeve mbahet akt konstatime/verifikime dhe përditëson dokumentacionin e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore, rillogarit vlerën e tarifës/taksës së re dhe klasifikimin në nivel tjetër detyrimesh. Kjo praktikë realizohet nga STTV. Për vitin 2023 nuk ka raste rivlerësimi tatimor.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

“Paketa fiskale 2023” është miratuar me VKB nr. 62 datë 28.12.2022 me nr. Prot. 1721/1 datë 28.12.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me nr. 1160/1 prot., datë 09.01.2023 konform kuadrit ligjor në fuqi. Nga të dhënat e pasqyrës përmbledhëse paraqitur në Aneks 4/ Tabela nr. 4, rezulton se: për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifatat (pa përfshirë grantin e qeverisë) janë realizuar në vlerën 7,640 mijë lekë ose në masën 95.5%; për vitin 2023 janë realizuar në vlerën 15,617 mijë lekë ose në masën 193%. Pra nga viti 2022 në vitin 2023 ka patur një rritje të të ardhurave prej 7,977 mijë lekë ose me 97.5% të tyre, ku peshën më të madhe të realizimit e ka patur kategoria II- “të ardhurat nga taksat e ndara” me 419% me një rritje nga viti 2022 prej 83% dhe peshën më të vogël e ka patur kategoria I – “të ardhura nga taksat vendore” me 47.6% por me një rënie nga viti 2022 prej (-)56.4%.

- Për vitin 2023, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 8,000,000 lekë po aq sa në vitin 2022 dhe janë realizuar në vlerën 15,617,324 lekë ose 7,976,727 lekë më shumë se viti 2022;
- Realizimi i të ardhurave për vitin 2023 është në masën 193%; ndërsa për vitin 2022 ishte në masën 95.5%;

Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023:

Nga informacioni i pasqyruar në Aneks 4/ Tabela nr. 4, vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar vlerë për t’u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse rezulton si më poshtë vijon:

- TNI për vitin 2023 nga legalizimet është parashikuar në vlerën 1,250 mijë lekë dhe është realizuar 715 mijë lekë ose 57.3% e vlerës së planifikimit, me (-)1,750 mijë lekë më pak se në vitin 2022 ose prej (-)143.7%;

- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 1,205 mijë lekë dhe është vjelë 592 mijë lekë ose në masën 49.1% të tij, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej (-)158 mijë lekë më pak se në vitin 2022 ose me (-)14.1%;

- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 1,302 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 460 mijë lekë ose në masën 35.4%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)193 mijë lekë ose me (-)14.8%.

- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 70 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 47.9 mijë lekë ose në masën 68.2%, me një rënie të ardhurash prej (-)5.8 mijë lekë nga viti 2022 ose prej (-)8.3%;

- Taksë table është parashikuar në vlerën 8 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 7.9 mijë lekë ose në masën 99.1%, krahasuar me vitin 2022 rezulton në rritje të vogël në vlerën prej 0.09 mijë lekë ose 1.1%;

- Taksë e mjeteve në qarkullim është parashikuar në vlerën 400 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 349 mijë lekë ose në masën 87.4%, krahasuar me vitin 2022 është 42 mijë më shumë ose me 10.6%;

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 janë planifikuar 1,800 mijë lekë dhe janë realizuar 959 mijë lekë ose 53.3%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të realizimit të të ardhurave prej (-)243 mijë lekë ose me (-)13.5%;

- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit janë planifikuar 800 mijë lekë dhe janë realizuar 383 mijë lekë ose 47.9%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)167 mijë lekë ose me (-)20.9%;

- Të ardhura nga tarifa të ndryshme: nga ujitje kullimi, nga shërbimet e MZSH, nga muzeu Nasi Lera, nga vozitje me varkën solar në liqen etj, janë planifikuar në total 354 mijë lekë dhe janë realizuar në total 208 mijë lekë ose në masën 58.8%, krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të të ardhurave prej 17.8 mijë lekë ose me 1.3%;

Të ardhura nga qiratë për vitin 2023 janë planifikuar 800 mijë lekë dhe janë realizuar 1,622 mijë lekë ose në masën 202.8%, krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të ardhurash prej 1,292 mijë lekë ose prej 161.6%;

- Të ardhura nga kamatëvonesat janë planifikuar në vlerën 10 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 2 mijë lekë ose në masën 20.3%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)2.7 mijë lekë ose prej (-)28.4%;

- Nga gjoha, sponsorizime dhe të tjera (shitje mallra e shërbime) nuk ka patur planifikime, por për dy vite radhazi janë arkëtuar në vlerat respektive: 847 mijë lekë, 7,313 mijë lekë dhe 780 mijë lekë; krahasuar me vitin 2022 kanë ardhur me rritje;

Konstatohet se: Për vitin 2023 nuk janë parashikuar të ardhurat nga "tatim nga të ardhurat personale/TAP", e cila llogaritet mbi bazën e listë pagesave të punonjësve të strukturës aktuale të miratuar (kryesisht të muajit nëntor). Kjo ka ardhur nga mungesa e komunikimit efektiv mes SFB dhe STTV;

Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e (mos)realizuara në vitin 2022, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Gjithashtu, nga auditimi *rezulton se* procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet jo vetëm në analizën e të dhënave dhe trendi i realizimit të të ardhurave nga vitet paraardhëse, por edhe nga kërkesat që STTV dhe SFB iu ka përcjellë për informacion njësisive të strukturës së Bashkisë që sigurojnë të ardhura, për të grumbulluar një informacion sipas nevojave për hartimin e paketës fiskale për vitin 2023. Kërkesat janë shkresore por të pa protokolluara në regjistrin e protokollit, në mospërputhje me kërkesat e kuadrit ligjor: Ligji nr. 9154/2003 "Për arkivat në RSH", "Normat Teknike Profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë".

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 62, datë 28.12.2022 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec, administrimin e tyre dhe penalitetët për kundërvajtjet administrative për vitin 2023"; si dhe me Rregulloren e brendshme kreu V, kap 9, pika 9.1- *"detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit të tatimeve"*.

II. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe arkëtimi i detyrimeve

Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mbledhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Pustec", për llogari të Bashkisë Pustec. Akt rakordimi me DPSHTRR realizohet vetëm nëpërmjet Degës së Thesarit Korçë, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008

“Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të germës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Korçë”. Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Në Bashkinë Pustec rakordimet bëhen nga Sektori i Financës dhe buxhetit. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023.

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (ZVRPP) tani ASHK Vendore. ASHK Vendore ka patur bashkëpunim me STTV/Bashkinë Pustec, për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Pustec me vlerën e përlllogaritur. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Nga auditimi *rezulton se* deri në 31.12.2023 rakordimet me DPSHTRR dhe ASHK Vendore, nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE.

- Grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin e lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore)⁷, dhe rezultoi se Bashkia Pustec nuk ka dhënë leje shfrytëzimi minerar në territorin e saj.

- Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) **konstatohet se** Bashkia Pustec nuk ka lidhur marrëveshje me UK-sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në moszbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

Detyrimet e familjarëve

▪ Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Sektorit të Taksave dhe Tarifave dhe Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore për abonentët familjarë.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet

⁷<http://ëëë.akbn.gov.al/regjistri-i-lejeve-minerare-aktive-shkurt-2023>

e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në stendat e bashkisë apo Njësi Administrative.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësve të terrenit, me qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Pustec nuk ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër kjo nuk është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti, pasi janë bërë njoftimet në bankat e nivelit të dytë.

- Pasqyra e familjeve të regjistruara si tatimpagues në territorin e Bashkisë Pustec për vitin 2023, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.5 /në lekë

Nr	Bashkia Pustec	Totali		Detyrimi vjetor për taksat e tarifat -2023									
		Nr Famil	Vlerë	Ndërtesa		Pastrim		Ndriçim		Truall		Tokë Bujq	
				Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera
1	Lajthizë	71	226,677	43	49,740	46	72,000	46	36,200	59	2,360	70	66,377
2	Zaroshkë	124	381,537	63	87,744	72	112,800	72	56,700	92	2,850	124	121,443
3	Pustec	361	1,073,561	175	220,880	260	393,600	260	199,400	274	6,639	356	253,038
4	Diellas	184	462,683	95	108,545	109	162,400	109	82,700	140	5,570	182	103,468
5	Cerje	89	190,767	44	43,290	0	0	69	16,000	58	1,810	89	129,667
6	Goricë e Madhe	167	583,006	103	126,020	126	192,800	126	97,500	144	4,364	165	162,322
7	Goricë e Vogël	115	382,327	72	96,711	87	132,800	87	67,000	101	3,545	111	82,271
8	Kallamas	240	780,266	162	178,213	163	244,000	163	124,100	215	6,450	234	227,503
9	Gllomboç	82	301,437	49	54,437	59	92,000	59	46,300	67	2,666	77	106,034
TOTALI		1,433	4,382,261	806	965,584	922	1,402,400	991	725,900	1,150	36,254	1,408	1,252,123
1433 familje në vlerën e detyrimit vjetor 2023 4,382,261 lekë													

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

- Situata e debitorëve familjarë për vitin 2023, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6/në lekë

Nr	Bashkia Pustec	Totali		Vlera debitore për taksat e tarifat 2023									
		Nr	Vlera	Ndërtesa		Pastrim		Ndriçim		Truall		Tokë bujq	
				Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera
1	Lajthizë	58	173,426	35	38,834	34	52,800	34	26,600	49	1,960	58	53,232
2	Zaroshkë	92	247,356	44	58,393	45	69,600	45	35,100	65	2,010	92	82,253
3	Pustec	306	871,992	141	171,020	208	315,200	208	159,800	220	5,579	306	220,393
4	Diellas	163	384,238	83	91,428	89	130,400	89	66,700	123	4,850	163	90,860
5	Cerje	88	188,467	44	43,290	0	0	19	14,400	48	1,810	88	128,967
6	Goricë e Madhe	136	441,796	82	96,596	95	144,800	95	73,300	113	3,390	136	123,710
7	Goricë e Vogël	99	322,189	62	81,990	71	110,400	71	55,600	87	6,090	99	71,104
8	Kallamas	228	730,470	154	168,447	151	226,400	151	115,100	203	3,095	228	214,433
9	Gllomboç	76	269,973	43	45,203	53	82,400	53	41,500	61	2,436	76	98,434
TOTALI		1,246	3,629,907	688	795,201	746	1,132,000	765	588,100	969	31,220	1,246	1,083,386
1246 debitorë familjarë në vlerën e debisë 3,629,907 lekë.													

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën nr.6, **rezulton se:**

- numrin më të lartë të debitorëve e ka *taksa e tokës bujqësore* me 1,225 debitorë në vlerën totale të detyrimit 1,083 mijë lekë, ku njësia qendër e Bashkisë/ Pusteci ka numrin më të lartë me 303 debitorë në shumën 220 mijë lekë dhe Lajthiza ka numrin më të ulët me 58 debitorë në vlerën 53 mijë lekë;

- *taksa e truallit* ka 969 debitorë në vlerën totale të detyrimit 31 mijë lekë, ku nga 9 fshatra të Bashkisë Pustec, Pusteci ka numrin më të lartë të debitorëve 220 në vlerën e debisë prej 5.5 mijë lekë dhe Lajthiza ka numrin më të ulët me 49 debitorë në vlerën 1.9 mijë lekë;

- *tarifa e ndriçimit* ka 765 debitorë në vlerën totale të detyrimit prej 588 mijë lekë, ku numrin më të lartë e ka Pusteci me 208 debitorë në vlerën e debisë prej 159 mijë lekë dhe numrin më të ulët Cerje me 19 debitorë në vlerën 14 mijë lekë;

- *tarifa e pastrimit* ka 746 debitorë në vlerën totale të detyrimit 1,132 mijë lekë, ku numrin më të lartë e ka Pusteci me 208 debitorë në vlerën e debisë prej 315 mijë lekë dhe fshati Lajthizë me 34 debitorë në vlerën e debisë prej 52.8 mijë lekë. Fshati Cerje që ka zero (0) debitorë pasi nuk aplikohet kjo tarifë për mos ofrim shërbimi;

- *taksa e ndërtesës* me 688 debitorë në vlerën totale të detyrimit prej 795 mijë lekë, ku numrin më të lartë e ka fshati Kallamas me 154 debitorë në vlerën e detyrimit prej 168 mijë lekë dhe numrin më të ulët fshati Lajthizë me 35 debitorë në vlerën e debisë prej 38.8 mijë lekë;

- Bashkia Pustec *nuk ka tarifë gjelbërimi* të aplikuar në territorin e saj, pasi nuk ka sipërfaqe të gjelbërta publike në shërbim të komunitetit;

Vlera prej 3,629,907 lekë e 1246 debitorëve, është kontabilizuar dhe konsiderohet e ardhur e munuar për buxhetin e Bashkisë Pustec, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2023. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

- Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura vlera debitoare e biznesit, familjarëve dhe institucioneve për taksat dhe tarifatat vendore si më poshtë vijon:

Tabela nr. 7/në lekë

Përshkrimi	Nr	Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2022	Nr	Arkëtuar nga detyrimi prapambet	Nr.	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorë biznes i madh	1	96,330			1		1	132,840
Debitorë biznes i vogël	10	203,862					10	213,769
Nëntotali I	11	300,192	2	34,766	2	81,183	11	346,609
Institucione	2							
Nëntotali II	2	57,000	1	18,000	1	20,000	2	59,000
Debitorë taksa e ndërtesës familje	1,009	3,223,414			27	634,674	1,036	3,858,088
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim,)	1,196	10,258,571			24	1,169,870	1,220	11,428,441
Debitorët taksa e tokës bujqësore	1,167	5,871,803			131	792,769	1,298	6,664,572
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.					-	-		-
Debitorët nga qirratë					-	-		-
Nëntotali III	1,291	19,353,788	64	1,032,594	92	3,629,907	1,319	21,951,101
Total Borxhi tatimor	1,304	19,710,980	67	1,085,360	95	3,731,090	1,332	22,356,710

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

▪ Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2023 në Bashkinë Pustec, është si mëposhtë:

Tabela nr. 8

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të vitit
1	Biznesi i Madh	2023	1	0	0	1
2	Biznesi i Vogël	2023	18	1	1	18
3	Institucione	2023	6	0	0	6
(1+2)	Gjithsej	2023	19	1	1	19

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 8, rezulton se Bashkia Pustec e ka mbyllur vitin 2022 me **19** biznese aktive në total, prej të cilëve: 1 BM, 18 BV dhe 6 Institucione;

- Është **1** regjistrim i ri, i cili klasifikohet si BV;

- Ka mbyllur aktivitetin **1** subjekt, i cili ka qenë i klasifikuar si BV;

- Bashkia Pustec në fund të vitit 2023 ka të regjistruar në total **19** biznese aktive si edhe në mbyllje të vitit 2022.

Pra rezulton se numri total i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, paraqitet në të njëjta nivele nga viti 2022 në vitin 2023 me një numër prej 19 biznesesh

▪ Subjekte fizike që kanë mbyllur aktivitetin dhe janë debitorë deri në mbyllje të vitit 2023 në Bashkinë Pustec janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9/Në lekë

Subjekti	Statusi	Data	Detyrimet	Penaliteti
S.Th.	Çregjistruar	07.01.2020	33,444	U.Bllokimi
S.M.	Pezulluar	08.07.2021	11,581	-/-
A.C.	Pezulluar	29.01.2018	17,370	-/-
Xh.P.	Pezulluar	06.12.2017	16,800	-/-
4	1 / 3		79,195	

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 9, **konstatohet** se kanë mbyllur aktivitetin me pezullim apo çregjistrim 4 subjekte debitorë, për të cilët nga ana e QKB janë kryer veprimet pa konfirmuar më parë statusin e tyre debitorë ose jo nga ana e STTV të Bashkisë Pustec.

Rezultoni se nga ana e STTV dhe QKB për periudhën nga viti 2022 e në vijim ka një bashkëpunim për mos veprim pezullimi pa vërtetimin e lëshuar nga ana STTV Bashkia Pustec.

Tabela nr. 10

Subjekte të mbyllura gjatë vitit 2022 BV	1
Subjekte të mbyllura gjatë vitit 2022 BM	
Subjekte të mbyllura gjatë vitit 2023 BV	1
Subjekte të mbyllura gjatë vitit 2023 BM	

Nga informacioni i pasqyruar edhe në tabelën nr. 10, rezulton se numri i aktiviteteve të pezulluara është i njëjtë nga viti 2022 në vitin 2023 me 1 subjekt, të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Pustec.

III. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2023.

1. Biznesi dhe Institucionet

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve përgjatë vitit 2023, për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, etj, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.11/në lekë

Përshkrimi	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2022	Nr	Paguar nga debia prapambetur	Nr	Borxhi krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorë biznes i madh	1	96,330	1		1		1	132,840
Debitorë biznes i vogël	10	203,862	1		1		10	213,769
Nëntotali I	11	300,192	2	34,766	2	81,183	11	346,609
Institucioni	2	57,000	1	18,000	1	20,000	2	59,000
Total Borxhi tatimor subjekte	13	357,192	3	52,766	3	101,183	13	405,609

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 11, **konstatohet se:** në fund të vitit 2023 në Bashkinë Pustec (9 fshatrat), janë debitor 11 subjekte debitorë në vlerën totale 346,609 lekë në numër të njëjtë debitorësh si në vitin 2022, por me rritje të vlerës së debisë prej 46,417 lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

- 1 subjekt “Biznesi i Madh” në vlerën 132,840 lekë, krahasuar me vitin 2022 debia ka vlerë në rritje prej 36,510 lekë;
- 10 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 213,769 lekë krahasuar me vitin 2022 debia ka vlerë në rritje prej 9,907 lekë;
- 2 subjekte “Institucione” në vlerën 59,000 lekë krahasuar me vitin 2022 debia ka vlerë në rritje prej 2,000 lekë.

Për debitorët e biznesit, rezulton se është aplikuar kamatëvonesa rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor.

Për institucionet debitorë aplikohet kamatëvonesa.

- Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar fletë njoftimet mbi detyrimet për subjektet debitorë; për debitorët është dërguar shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë me nr. 179 prot., datë 07.02.2023; shkresa nr. 180 prot., datë 07.02.2023 në DPSHTRR për masë bllokimi mjeteve të transportit.

Pra rezulton se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare” si rezultat i masave të marra është bërë i mundur arkëtimi nga borxhi në vlerën 57,766 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar në marrjen e masave të tjera shtrënguese si: bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve etj, deri në kallëzim penal.

-Veprime apo mosveprime në kundërshtim me Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
Shkronjën “a” të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
-VKB nr. 62 prot., datë 28.12.2022.

▪ Një klasifikim i llojit të aktiviteteve referuar klasifikimit të subjekteve bashkë me detyrimin/debinë për vitin 2023, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12/në lekë

LLOJI I SUBJEKTIT	NUMRI	LLOJI I AKTIVITETIT	MATURIMI VJETOR 2023	DEBI NË FUND 2023	EMRI I SUBJEKTIT
BIZNESI I MADH					
	1	Fasoneri	36,510	36,510	P. T.
BIZNESI I VOGËL					
	1	Tregëti Lëndë Djegëse	32,708	-	
	4	Bar- Restorant	147,675	-	
	6	Tregëti me pakicë	114,778	16,249	D.S.
	1	Furrë Buke	17,557	-	
	1	Servis Makinash	28,424	28,424	D.S.
	2	Bar- Bufe	56,451	-	
	2	Bar-Bufe -Restorant	87,172	-	
	1	Konsulencë në fushën IT	12,772	-	
	1	Bar -Bufe -Tregëti me pakicë	22,634	-	

Burimi: STTV /Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.12, rezulton se aktivitetet sipas llojit që ushtrohen në territorin e Bashkisë Pustec, janë parashikuar dhe miratuar në Paketën Fiskale të vitit 2023.

▪ Gjendja e subjekteve debitorë e shpërndarë sipas vitit të krijimit deri në fund të vitit 2023, është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 13/në lekë

Nr	Subjekti Debitor	Aktiviteti	Vitet e krijimit të debisë						
			2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1	F.Ch.	BM /fasoneri				23,310	36,510	36,510	36,510
2	Xh. P.	BV/tregeti pakice	16,800						
3	N. M.	-/-	19,200						
4	A. Ç.	Bar kafe	17,370						
5	F.K.	Tregëti pakice	17,950						
6	S.Th.	-/-	10,250	12,731	10,463				
7	T. A.	Ushqimore				7,827			
8	S. M.	Bar kafe					11,581		
9	D. S.	Tregeti pakice							16,249
10	D. S.	Servis makinash							28,484
11	V.T.	Tregeti pakice						11,317	
11	Totali		98,820	29,088	10,463	31,137	48,091	47,827	81,183
									346,609

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Një klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur është si më poshtë vijon:

Për biznesin e vogël

1.Debitorë pa shpresë arkëtimi janë **5** në vlerën totale **104,764** lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë **1**në vlerën totale **7,827** lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë **4** në vlerën totale **67,631** lekë;

10 **213,769** lekë

2. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 0 , në vlerën totale	0 lekë;
Debitorë nga 2 deri në 5 vite është 1, në vlerën totale	132,840 lekë;
1	132,840 lekë

Nga verifikimi i dosjeve të subjekteve debitorë, rezultoi se:

- Nga ana e STTV është bërë verifikimi në sistemin e QKB mbi statusin e tyre dhe ekstraktet e QKB-së janë bërë pjesë e dosjes.

- U **konstatua** se për BM debitori "P. T." është inspektuar në terren dhe janë përpiluar dy Akt konstatime: nr. 0000003 datë 07.06.2023 dhe nr. 0000004 datë 11.12.2023, nga të cilët rezulton se ky subjekt nuk e ushtron më aktivitetin në objektin dhe adresën e deklaruar, nuk ka bazë materiale, makineri dhe fuqi punëtore, pra ka braktisur objektin dhe aktivitetin. Në QKB rezulton "aktiv" dhe pa dorëzuar pasqyrat financiare të bilancit për vitin 2022. Nga komunikimi verbal mes STTV Bashkisë Pustec dhe financierit të subjektit "P. T.", është konfirmuar se administratori i subjektit i njeh detyrimet dhe se do i paguajë për një periudhë të mëvonshme. Nga Urdhri i bllokimit dërguar bankave të nivelit të dytë, u transferuan në llogari të bashkisë gjendja e llogarisë bankare e subjektit në vlerën prej 50,000 lekë, vlerë e cila i është zbritur vlerës totale të debisë.

Gjithashtu *konstatohet* se: 1. Në Bashkinë Pustec janë zhvilluar takime të GMS ku trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, por *rezulton* se këto takime nuk janë dokumentuar; si dhe nga mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse (GMS dhe STTV), nuk është hartuar një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

2. Mungesa e Aplikimit të penaltiteteve me shkresa për bllokimin e aseteve regjistruar në ASHK;

3. Njoftimi i subjekteve debitorë dhe familjare kryhet nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve, si edhe me njoftimet në stendat e bashkisë dhe në qendrat e fshatrave.

- Nisur nga kushtet specifike të komunitetit që përbën këtë bashki, nga ana e STTV na u komunikua se vështirësia e vjeljes së taksave dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura vjen nga fakti se popullata është emigratore.

- Për institucionet debitorë është dërguar urdhër bllokimi në bankat e nivelit të dytë, për shlyerje të detyrimeve që ato kanë ndaj Bashkisë Pustec.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga struktura tatimore e bashkisë Pustec, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181, "Mos pagimi i taksave dhe tatimeve", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

"Mos pagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë" pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

1. Debitorët familjarë: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit: gjelbërim, pastrim, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe TNI

Tabela nr. 14/në lekë

Përshkrimi	Nr	Vlera borxhit progresive më 31.12.2022	Nr	Paguar nga debia progresive	Nr	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorë taksa e ndërtesës familje	1,009	3,223,414			688	795,201	1,036	3,858,088
Debitorët taksat familje /truall					969	31,220		
Debitorët taksat familje /pastrim	1,196	10,258,571			746	1,132,000	1,220	11,428,441
Debitorët taksat familje /ndriçim					765	588,100		
Debitorët taksa e tokës bujqësore	1,167	5,871,803			131	792,769	1,298	6,664,572
Nëntotali	1,291	19,353,788	64	1,032,594	1,246	3,629,907	1,319	21,951,101
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.								54,110
Debitorët nga qiratë								-
Numri total i debitorëve	3372				3,299		3,556	
Total Borxhi tatimor për familje	1,291	19,353,788	64	1,032,594	1,246	3,629,907	1,319	21,951,101

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Nga auditimi i evidencave dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.14, rezulton se në mbyllje të vitit 2023 numri i debitorëve familjarë ka ardhur me rritje nga 1291 debitorë progresivë familjar në mbyllje të vitit 2022 në 1,319 debitorë ose 28 debitorë më shumë se në vitin 2022, me rritje të vlerës së debisë progresive prej 2,597,313 lekë më shumë, e ndarë si më poshtë vijon:

- 1036 debitorë “për taksë ndërtese” në vlerën 3,858,088 lekë ose 27 debitorë më shumë se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rritje prej 634,674 lekë;
- 1,220 debitorë “taksa familjare” në vlerën 11,428,441 lekë ose 24 debitorë më pak se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rritje prej 1,169,870 lekë;
- 1,298 debitorë “për taksa tokë bujqësore” në vlerën 6,664,572 lekë ose 131 debitorë më shumë se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rritje prej 792,769 lekë;
- Një analizë e detajuar e debisë progresive nga viti i krijimit deri në fund të vitit 2023 për çdo fshat të Bashkisë Pustec, pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.15 /në lekë

Nr	Bashkia Pustec	Totali		Vlera debitoare për familjarët nga taksat e tarifave vendore							
		Nr	Vlerë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Lajthizë		1,095,616	71,727	120,787	152,897	158,537	139,629	126,770	151,843	173,426
2	Zaroshkë		1,240,445	72,866	103,530	154,880	163,765	191,437	135,287	171,424	247,256
3	Pustec		5,066,872	302,210	533,322	669,429	674,426	668,573	601,102	745,818	871,992
4	Diellas		2,736,921	167,220	325,570	391,320	409,960	419,183	323,308	316,122	384,238

5	Cerje		1,311,791	114,678	148,364	160,961	170,621	207,283	156,233	165,184	188,467
6	Goricë e Madhe		2,543,082	116,239	254,810	336,249	361,779	376,216	272,554	383,439	441,796
7	Goricë e Vogël		1,620,962	91,520	159,310	198,642	194,812	220,695	184,250	249,544	322,189
8	Kallamas		4,654,408	300,250	479,978	618,713	670,525	635,228	594,338	624,906	730,470
9	Gllomboç		1,681,004	122,974	166,136	219,088	236,689	244,631	192,868	228,646	269,973
TOTALI		1,319	21,951,101	1,359,684	2,291,807	2,902,179	3,041,114	3,102,875	2,586,709	3,036,926	3,629,807
TRENDI											
Diferenca					932,123	610,372	138,935	61,761	(-)516,166	450,217	592,881

Burimi: SSTV/Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 15, konstatohet se:

- Vlera debitorë ka ardhur në rritje nga viti i krijimit 2016 deri në vitin 2020, kjo pasi në vitin 2021 nga të gjitha familjet debitorë janë bërë pagesa duke e ulur vlerën e debisë në 2,586,709 lekë ose me 516,166 lekë më pak. Por ky trend nuk vazhdon për periudhën në vijim, duke rezultuar me rritje të debisë në 3,036,936 lekë në vitin 2022 ose me rritje të debisë prej 450,217 lekë më shumë se viti 2021 dhe në vlerën 3,629,807 lekë në vitin 2023 ose me rritje të debisë prej 592,881 lekë më shumë se viti 2022;

- Gjithashtu vlera e debisë ka ardhur në rritje për çdo fshat nga vitin vit, ku vlerën më të lartë totale e ka Pusteci me 5,066,872 lekë ose në masën 23.1% të vlerës totale të debisë; ndërsa vlerën më të vogël të debisë e ka Lajthiza në vlerën 1,095,616 lekë ose në masën 5% të vlerës totale progresive të debisë.

Konkluzion: Deri në 31.12.2023 janë në total 1,319 familjarë që taksohen në Bashkinë Pustec për taksa e tarifa vendore (t. ndërtese, t. pastrimi, t. ndriçimi, t. trualli dhe t. toke bujqësore) në vlerën totale progresive prej 3,629,807 lekë, vlerë e cila është kontabilizuar.

Për sa më lart mosveprimet janë në kundërshtim me VKB- nr. 62 prot., datë 28.12.2022 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Pustec, penaltitetet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023".

Për sa më lart mosveprimet janë në kundërshtim me VKB- nr. 62 prot., datë 28.12.2022 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Pustec, penaltitetet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023".

- **Familje debitore për taksën e tokës bujqësore.**

Referuar tabelës nr. 16, rezulton se vlera debitorë progresive për taksën e tokës bujqësore, është nga 1,022,258 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 2,834,191 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë të debisë në rritje prej 437,002 lekë. Theksojmë se sipërfaqja e tokës bujqësore të taksuar është bërë mbi bazën e vetë deklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore dhe nga regjistri i ndarjes së tokës në zbatim të ligjit nr. 7501 /1991. Nga ana e sektorit të bujqësisë nuk janë bërë riverifikime në terren me qëllim sigurimin e të dhënave të sakta dhe krijimin/përditësimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë tokë si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri të madh i familjeve debitorë në vlera të konsiderueshme debitoare. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Njoftim detyrimet për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistra, bëhen në kohë, por emigrimi i tyre ka sjellë vonesa dhe është shfrytëzuar rasti kur fermerët janë

paraqitur pranë Bashkisë për shërbime të ndryshme dhe shërbimi i kërkuar është ofruar pasi iu janë prerë faturat dhe janë bërë arkëtimet.

Tabela nr.16/në lekë

Nr.	Fshatrat	Nr. Familjeve	Vlera 31.12.2022	Nr. Familjeve	Vlera 31.12.2023	
1	Lajthizë	55	50,453	58	53,232	
2	Zaroshkë	87	74,856	92	82,253	
3	Pustec	293	211,654	306	220,393	
4	Diellas	155	86,445	163	90,860	
5	Cerje	78	111,654	88	128,967	
6	Goricë e Madhe	136	113,444	136	123,710	
7	Goricë e Vogël	90	62,485	99	71,104	
8	Kallamas	208	201,420	228	214,433	
9	Gllomboç	81	89,847	76	98,434	
	Totali	1,183	1,022,258	1,246	1,083,386	Diferenca 1,128

Burimi: Bashkia Pustec

Gjatë vitit 2023 *konstatohet* se numri i familjeve debitorë nga mospagimi i taksës së tokës bujqësore ka ardhur në rritje nga 1183 në mbyllje të vitit 2022 në 1246 debitorë në mbyllje të vitit 2023; Kjo është shoqëruar me rritje të vlerës së debisë me 61,128 lekë më shumë se debia e vitit 2022; numrin më të lartë të debitorëve e ka Pusteci (306) dhe numrin më të vogël e ka Lajthiza (58).

Tabela nr. 17/në lekë

Fshatrat	Debi progresive deri në 31.12.2022	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Debitorë krijuar në vitin 2023 (Lekë)		Debia Progresive 31.12.2023
				Numri debitorë	Debia	
Lajthizë	296,610	50	576,170	131	46,592	343,202
Zaroshkë	404,992	81	1,029,614		9,764	414,756
Pustec	1,156,008	230	2,120,042		159,662	1,315,670
Diellas	520,056	112	877,588		82,692	602,748
Cerje	682,734	65	1,220,871		128,504	811,238
Goricë e Madhe	718,575	116	1,514,483		30,594	749,169
Goricë e Vogël	343,719	83	613,586		56,314	400,033
Kallamas	1,212,287	154	1,468,696		196,513	1,398,800
Gllomboç	536,822	60	742,081		92,134	628,956
Totali	5,871,803	951	10,163,131	131	792,769	6,664,572

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 17, *konstatohet se:*

- vlera progresive e debisë në fund të vitit 2023 është 6,664,572 lekë krahasuar me vitin 2022 ka rritje të debisë me një vlerë prej 792,769 lekë;

- Fshati Kallamas ka vlerën debitorë progresive më të lartë prej 1,398,800 lekë dhe Lajthiza ka vlerën më të vogël të debisë progresive prej 343,202 lekë.

Mosveprimet janë në kundërshtim me VKB nr. 62 prot., datë 28.12.2022, Për miratimin e paketës fiskale 2023.

- Sipas bonitetit sipërfaqja e tokës bujqësore në territorin e bashkisë Pustec pasqyrohet e klasifikuar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.18/nëlekë

Kategoria e Tokës	Sipërfaqe e tokës bujqësore në ha										Lekë ha/vit sipas VKB	Pritshmë (në lekë)
	Sipërfaqe Total	Lajthize	Zaroshke	Pustec	Diellas	Cerje	Gorice Madhe	Gorice Vogel	Kallamas	Gllombo c		
Kategoria e IV	164.1778	-	-	-	-	-	-	18.0070	112.4914	33.6794	1610	264,326

Kategoria e V	250.9684	14.0720	29.1346	86.8664	22.8213	-	-	29.9793	33.9413	34.1535	1330	333,788
Kategoria e VI	451.5487	35.7210	73.8268	105.9821	62.9719	70.2768	98.2973	3.8703	0.2325	0.3700	1120	505,735
Kategoria e VII	149.4342	7.8240	-	19.1557	1.9656	51.8103	53.1510	9.5020	0.2044	6.0052	980	146,446
TOTALI	1,016.3131	57.6170	102.9614	212.0042	87.7588	122.0871	151.4483	61.3586	146.8696	74.2081		1,250,295
Arkëtuar												460,480

Burimi: SB/Bashkia Pustec

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 18, konstatohet se për 1016.3131 ha tokë bujqësore të ndarë me ligjin 7501, referuar tarifave të miratuara me VKB në paketën fiskale 2023, pritshmëria e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore për vitin 2023 është 1,250,295 lekë dhe në fakt për vitin 2023 janë arkëtuar 460,480 lekë ose 36.8% e detyrimit total vjetor të pritshëm. Duhet theksuar fakti që edhe pse vlera e taksës për vitin 2023 është ulur me 30% të asaj të miratuar në vitin 2022, përsëri numri dhe vlera e arkëtimeve është e ulët dhe vjen me rënie nga viti në vit.

Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore

Nga Zyra e Administrimit të Tokës Pustec, është marrë ky informacion lidhur me sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi të ndarë me Ligjin 7501 /1992, si më poshtë⁸:

Bashkia Pustec	Sipërfaqja në ha		
	Të ndara	Të pandara (Shtetërore)	
		Me origjinë nga ish.Koop.bujqësore	Me origjinu nga ish.Nb. bujqësore
Bashkia Pustec	1,016	-	-

Burimi: SB/Bashkia Pustec

▪ Tokat bujqësore të Bashkisë Pustec sipas ndarjes pasqyrohen si më poshtë:

Emërtimi i asetit	Sip. në ha
Pyje	250.0
Kullotë	31.8
Toka joproduktive	-
Shkëmbore e ujore	-
Djerrë	-
Bimësi Pyjore	-
Totali	281.8

Burimi: SB/Bashkia Pustec

▪ Tabela e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Pustec për vitin 2023

Bashkia Pustec ka sipërfaqe pyjore në pronësi sipas VKM-së Nr.433 datë 8.05.20216 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike”;

- Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori e Bujqësisë [SB], *rezulton* se ky sektor ka dërguar çdo vit në Këshillin e Qarkut Korçë, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor, sipas formularë të miratuar Formular 1, 2, 3 dhe 4.

Njësi Administrative	Sipërfaqja në ha			
	Kullota	Pyje	Inproduktive	Shkëmbore e ujore
Bashkia Pustec	250	31.8	-	-

Burimi: SB/Bashkia Pustec

Nga auditimi *rezultoi* se:

⁸ Informacion i detajuar në tabelën nr. 18

- Bashkia Pustec nuk ka kontrata verore /dimërore të lidhura për shfrytëzimin e kullotave dhe si rrjedhojë nuk ka as debitorë;
- Bashkia Pustec nuk ka dhënë toka bujqësore me qira.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Pustec, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2023, i paraqitur nga Sektori i Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Pustec deri në 31.12.2023, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Pustec. Nga ZVASHK Korçë, janë dërguar informacioni dokumentar për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Bashkisë Pustec. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Bashkia Pustec, nuk ka detyrime të prapambetura të trashëguara ndër vite për TNI.

Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën e vitit 2023 dhe statusi.

▪ Tabela përmbledhëse - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për legalizimin e objekteve informale për vitin 2023:

Tabela nr. 19 /në lekë

Shkresë ardhur nga ASHK Korçë Nr.Prot	Data	Emër Atësi Mbiemër	Sip. Totale (m²)	Zona kadastrale	Funksioni	Autorizim	Vlera e TNI(lekë)	Statusi
428	23.01.2023	L. P. Th.	250.2	3893	banesë	po	43,785	paguar
		V. Gj. G.	163.6	1810	-/-	-/-	28,630	paguar
478	23.01.2023	J.E.T.	109.2	1797	-/-	-/-	19,110	paguar
957	15.02.2023	Dh.V. K.	404.0	1809	-/-	-/-	70,700	-/-
		N.Gj. A.+BP	172.4	2462	-/-	-/-	30,170	-/-
		T. F. J.+BP	130.8	3893	-/-	-/-	22,890	-/-
958	15.02.2023	E. P. S.	100.8	2045	-/-	-/-	17,640	-/-
		S.P. B.	174.6	2462	-/-	-/-	30,555	-/-
1726	21.03.2023	Gj.Ll. A.	152.3	2462	-/-	-/-	26,652.5	-/-
2733	08.06.2023	Gj.Ll. I.	145.6	2462	-/-	-/-	25,480	paguar
3466	24.07.2023	L.R. K.	131.4	2045	-/-	-/-	22,995	paguar
		R.P. M.	175.3	2462	-/-	-/-	30,677.5	-/-
7		12				12	369,285	

Burimi: SUMT/Bashkia Pustec

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.19 rezulton se gjatë vitit 2023 janë dërguar 5 shkresa nga ASHK Rajonale Korçë, me listë emërore të 12 përfituesve të lejeve legalizimit për Bashkinë Pustec. Ndaj Bashkisë Pustec nuk ka debitorë për TNI nga leje legalizimet. Për vitin 2023 nuk ka debitorë për TNI.

▪ Lidhur me lejet e ndërtimit të dhëna nga SUMT/Bashkia Pustec, *rezulton se* në vitin 2023 është dhënë vetëm një leje, e cila ka paguar TNI brenda afateve ligjore. Një informacion i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 20

Lejet e dhëna nga SUMT/Bashia Pustec në vitin 2023							
Lloji i lejes	Emërtimi i objektit	Zhvilluesi	Preventivi (lekë)	Vlera e TNI-së (lekë)	Nr. vendimi, datë, nr. prot;	Sip. totale ndërtimi (m ²)	Shënime mbi kontributin ndaj fondit publik për strehim social
Njoftim fillim punimesh	Rikonstruksion pa ndryshim funksioni të banesës ekzistuese 1 kat, edhe shtesë anësore dhe në lartësi 1 kat e papafingo (me sipërfaqe deri në 250 m ²)	xx	2,183,026	196,000	Nr. 335, datë 06.01.2023	140	zz

Burimi: SUMT/Bashkia Pustec

Tarifa e pastrim, gjelbërim, ndriçim etj (sipas rastit), për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike.

Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrim, ndriçimit, etj, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, *rezultoi se* gjatë viti 2023 kanë kryer punime ndërtimi 3 subjekte, nga të cilat një subjekt ka fituar dy procedura prokurimi. Informacioni i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Objekti	NIPT	Vl.kont. (pa tvsh)	Afati i i kontratës	Lloji i taksave dhe tarifave vendore						
					Debi 31.12.2023	Taksë Tabele	Tarifë Pastr.	Tarifë Ndriçim	Tarifë Gjelb.	Paguar	Debitor
1	Mirëmbajtje ndërtesa parafabrikate	AL-D. Shpk J.....Q	345,760		0		1,250			po	jo
2	Përmirësim banesave ekzistuese komunitetit	N. Shpk J.....U	10,187,289	27.10.2023-26.01.2024	0		3,000			po	jo
3	Sistemi i shtratit të përroit Gorice Madhe	N. Shpk J.....U	30,934,840	29.08.2023-29.01.2024	0		3,000	500		po	jo

Burimi: Bashkia Pustec

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit në *tabelën nr. 21, rezultoi se* gjatë vitit 2023 janë 2 OE që kanë fituar procedurat e prokurimit për 3 punë publike me fondet e Bashkisë dhe se kanë paguar detyrimin mbi taksat vendore ndaj Bashkisë Pustec.

Tarifa për vizitat në muzeun "N. L."

Referuar Paketës Fiskale 2023 tarifat e miratuara për vizitorët në muzeun "N. L.", janë miratuar dy vlera të ndryshme të tarifës për dy kategori vizitorësh: vizitorë dhe nxënës shkolle/studentë:

Në lekë

Viti 2023			
Kategori vizitorësh	Vlera sipas VKB (lekë)	Nr	Vlera arkëtuar
Vizitorë	100	93	28,100
Nxënës/studentë	50		

Burimi: Bashkia Pustec

Tarifa për vozitjen me varkë në liqen

Bashkia Pustec shfrytëzon resurset natyrore për promovimin e tyre me qëllim rritjen e të ardhurave për buxhetin e bashkisë nga vendosja e tarifave modeste. Kjo realizohet nëpërmjet

varkës solar e cila për vitin 2023 ka siguruar të ardhura në vlerën 20,000 lekë nga 64 udhëtarë, vlerë kjo e pasqyruar dhe në pasqyrën e të ardhurave plan/fakt të vitit 2023.

Tarifa nga peshkimi amator

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Pustec edhe pse ka në territorin e saj Liqenin e Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, nuk ka arritur për asnjë vit të sigurojë të ardhura nga peshkimi amator në ujërat e këtyre liqeneve. Nga STTV na u komunikua se janë bërë herë pas here përpjekje, por nuk është mundur të realizohet. Shoqata e peshkatarëve nuk ka pranuar të paguajë detyrimin vjetor ndaj Bashkisë Pustec ndonëse është në vlera modeste, e miratuar kjo me VKB në Paketat Fiskale vjetore. Për vitin 2023 është në vlerën 2,000 lekë.

Nisur nga ky fakt, grupi i auditimit duke iu referuar gjithë kuadrit ligjor mbi peshkimin dhe akuakulturën, dhe konkretisht:

- Ligji nr. 64/2012 "Për peshkimin" i ndryshuar;
- Vendim nr. 407, datë 8.5.2013 "për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim";
- Vendim - nr. 302, datë 10.4.2013 - "për ngritjen e sistemit të inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të pa raportuar (ppp) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim";
- Vendim - nr. 402, datë 8.5.2013 - "për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det";
- Vendim nr. 256 datë 24.4.2019" për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit";
- Urdhër nr. 149 date 31.3.2022 - "rregullorja e peshkimit";
- Ligji nr. 103/2016 "Për Akuakulturën"

arriti në përfundimin se: në kuadrin ligjor të mësipërm, nuk përcaktohet qartë roli, përgjegjësia dhe përfitimet e njësive të vetëqeverisjes vendore /Bashkitë, në territorin e të cilave përfshihen formacione ujore detare, lumore apo liqenore, me qëllim rritjen e të ardhurave në buxhetin e tyre nëpërmjet tarifimit të llojeve të ndryshme të peshkimit si aktivitete jo vetëm tregtar, por edhe shlodhës-argëtues dhe studimor.

IV.Burimi i krijimit të të ardhurave jo tatimorë.

Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga auditimi, rezulton se gjatë vitit 2023 Policia Bashkiake nuk ka regjistruar gjoba për kundërvajtje administrative në territorin e Bashkisë. Pustec.

Nga gjobat e IMT-së

Nga auditimi dhe relacioni i inspektorit të IMT-së Bashkia Pustec, rezulton se gjatë vitit 2023 nga kontrollet periodike të ushtruara në territorin e Bashkisë Pustec nuk janë konstatuar ndërtime të jashtëligjshme dhe kundërvajtje administrative.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste

Bashkia Pustec referuar kuadrit ligjor në fuqi, ka aplikuar lidhjen e marrëveshjeve me debitorët për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura prej tyre, në favor të buxhetit të Bashkisë Pustec. Një informacion i detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.22 /Në lekë

Marrëveshje	Subjekti	Detyrimi Tatimor periudha 2017, 2018, 2022,2023					Shuma totale dhe statusi	Afati i likuidimit
		Takse ndertese	Takse trualli	Tarife pastrimi	Tarife ndriçimi	kamatvonese		
Nr. 1360 prot., datë 18.10.2023	V.T L.....K	27,472	1,686	34,200	4,200	11,433	78,991	25.11.2023- 25.11.2024 7 këste
							Likuiduar brenda afatit	

Burimi: Bashkia Pustec

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Pustec mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

-VKB për miratimin e paketave fiskale për vitin 2022, përkatësisht VKB nr.113, datë 06.12.2021, në të cilat është përcaktuar tarifa e licencimit, si dhe sektori përgjegjës për lëshimin e licencës, faturës së arkëtimit;

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante për konsuPustecorët fundorë në Bashkisë Pustec në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 23

Nr	Subjekti	Nipti	Administratori	Adresa	Nr. Dt. Afati	Shenime
1	B. S.	K.....S	-	Lajthizë/ Bashkia Pustec	Nr. 1098 prot., dt.03.09.2021 03.09.2021-02.09.2026	Paguar me 2 këste: MA nr. 380 dt. 01.09.2021, paguar 500,000 lekë MA nr. 19.08.2022 Paguar 500,000 lekë

Burimi: Bashkia Pustec

Nga informacioni i evidencave të vëna në dispozicion dhe i pasqyruar në tabelën e mësipërme, *rezulton se* në Bashkinë Pustec ushtron aktivitetin vetëm 1 subjekt, i cili i ka paguar të gjitha detyrimet ndaj Bashkisë Pustec.

Nga aktiviteti i MZSH

Gjatë vitit 2023 nga Sektori i MZSH janë siguruar këto të ardhura për buxhetin e Bashkisë Pustec:

Në lekë

Llog. ekonomike	Emërtimi	2023
7113011	Të ardhura nga shërbimet e MZSH	5,000

Burimi: STTV dhe MZSH/Bashkia Pustec

V. Përfshirjet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

Tabela nr. 24/Në lekë

Përfshirjet nga Taksat dhe Tarifat Vendore 2023								
Kategoria sociale	Tarifë pastrimi		Tarifë ndriçimi		Taksë ndërtese		Totali	
	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë
Familje me ndihmë ekonomike	58	46,400	58	17,400	50	54,272	166	118,072
Pensionistë të vetëm	-	-	-	-	300	328,843	300	328,843
Invalidë, paafësi	31	24,800	31	9,300	-	-	62	34,100
Totali	89	71,200	89	26,700	350	383,115	528	481,015

Burimi: STTV/Bashkia Pustec

Në Paketën Fiskale 2023, janë parashikuar nga STTV dhe miratuar me VKB nr. 62 datë 28.12.2022 edhe disa kategori sociale për tre lloj taksash: Taksë Ndërtese, Tarifë ndriçimi dhe tarifë pastrimi, të cilat në mënyrë të detajuar pasqyrohen në tabelën e mësipërme. Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 24 rezulton se për 3 kategoritë sociale përfituese janë në total 528 përfitues në vlerën 481,015 lekë.

STTV ka evidencë të hartuar mbi vlerën e vjelë të tyre dhe vlerën e plotë të taksave që duhej të arkëtohej në rast se nuk do përfshihej në paketën e lehtësisë fiskale.

Komisioni i Apelit Administrativ

Bashkia Pustec ka ngritur Strukturën e Hetimit Tatimor [SHT] me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 15/1 datë 19.01.2023 dhe me nr. 89/1 prot., datë 19.01.2023, në zbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 7 i tij;

KHT për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 është i përbërë si më poshtë vijon:

Tabela nr.25

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional/arsimor
1	A.P.	N/Kryetar	Agjent Doganor
2	V. S.	P/SBNJP	Ekonomik
3	P. R.	Specialist Arkitekt SU	Arkitekt
4	Q.Th.	Inspektor/P/STTV	Ekonomik
5	C. N.	P/SFB	Financë

Burimi: Bashkia Pustec

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023, nuk ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Pustec.

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultoi se debia progresive deri në datën 31.12.2022 është 19,710,980 lekë për 1304 debitorë, ndërsa deri në datën 31.12.2023, debia progresive është **3,731,090 lekë** për 1332 debitorë, të cilat janë kontabilizuar dhe konsiderohen si të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pustec.

Detyrimi ndaj Bashkisë Pustec në mënyrë të detajuar është si më poshtë:

- Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve [t. ndërtese+t.trualli+t.pastrimi+t.ndriçimi+t.t bujqësore] për vitin 2023 është në vlerën **3,629,907** lekë për 92 debitorë dhe në vlerën progresive **21,951,101 lekë** për 1319 debitorë;
- Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh për vitin 2023 është në vlerën **81,183 lekë** për 11 debitorë dhe vlera progresive është **346,609 lekë** për 11 debitorë;

3. Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga Institucionet për vitin 2023 është **20,000** lekë për 1 debitor dhe në vlerën progresive **59,000 lekë** për 2 debitorë;

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, sa prej tyre janë me certifikatë pronësie.

Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2023:

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, dërguar Degës së Thesarit Korçë me shkresën nr. 1137 prot., datë 30.08.2024, të përbëra si vijon:

Formati nr. 1: Pasqyra e pozicionit financiar;

Formati nr. 2: Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);

Formati nr. 3: Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow);

Formati nr. 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;

Formati nr. 5: Pyetësor dhe shënimet shpjeguese;

Formati nr. 6: Investimet dhe burimet e financimit;

Formati nr. 7/a: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike);

Formati nr. 7/b: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto);

Formati nr. 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave;

Pasqyrat financiare janë nënshkruar nga z. C.N., si Nëpunës Zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. P. K., Nëpunës Autorizues.

Pasqyrat Financiare	Administrata dhe Njësitë e Varësisë	Data e dorëzimit në Degën e Thesarit Korçë
Bashkia Pustec Nr. 1137 prot., datë 30.08.2024	Bashkia Pustec (administrata)	Prot. Nr.- dt. 02.09.2024

Pasqyrat financiare të administratës së Bashkisë janë përgatitur nga Sektori i financës dhe buxhetit dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Korçë për vitin ushtrimor 2023 me shkresën nr. 1137 prot., datë 30.08.2024 dhe miratuar datë 02.09.2024 nga Dega e Thesarit Korçë, në tejkallim të afatit liqor;

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke, (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, u konstatua se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i

mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

Mos ndryshueshmërinë e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera, pohojmë se:

Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale dhe pjesërisht informatike në programin "EXCEL" dhe jo me program të veçantë.

Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Në tërësi, organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Kështu: Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë hartuar me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues, si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të

kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit, të shoqëruar me urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshëm për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomik –financiar të vitit 2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 39,313,887.87 lekë.

Materialiteti për shpenzimet është vlerësuar 8,830,913 lekë, ndërsa për të ardhurat është vlerësuar 1,079,150 lekë. Përlllogaritja e vlerës së materialitetit është paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Mbajtja e kontabilitetit për vitin 2023:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, rezulton se:

	<u>Viti 2022</u>	<u>Viti 2023</u>
Aktivet	577,210,374 lekë	866,930,719 lekë
Pasivet	161,672,540 lekë	129,467,467 lekë
Aktivet neto	415,537,834 lekë	737,463,252 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 866,930,719 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 93,400,885 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 21,880,572 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 126,020,217 lekë lekë.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore 2023, sipas Formatit nr. 1, Pozicioni Financiar, është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 93,400,885 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 48,448,484 lekë, të cilat kundrojnë me vlerat në rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-floë), që sipas metodës direkte. pasqyrohet si në tabelën e paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 93,400,885 lekë, përbëhet nga: të ardhura dhe transfertat e pakushtëzuar që trashëgohen llogaria 85 (Kredi) në vlerën 67,467,157, si dhe gjendja e llogarisë 466 në shumën 25,933,728 nga e cila: “pulla” në vlerën 55,000 lekë dhe “Mjetet në ruajtje” në vlerën 25,878,728 lekë që përbën 5% garanci kontrate. Pra llog. 520 kuadron me shumën e llog. 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje”.

Janë rakorduar me Degën e Thesarit Korçë, mbartjet e të ardhurave dhe transfertave të vitin 2023 si më poshtë:

1-Trasferta e pakushtëzuar viti 2023 e papërdorur 16,403,301.47 lekë.

2-Trasferta specifike viti 2023 e papërdorur 43,233,561.24 lekë.

3-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 7,830,294.67 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 67,467,157 lekë, fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2024 dhe *rakordojnë* me vlerën e llog.85 “rezultat i veprimtarisë ushtrimore”.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, janë paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar Pustec në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 21,880,572 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 5,251,168 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte/inventari imët” në shumën 16,629,404 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (-)112,930 lekë.

Llogaria 31 “Materiale”, në fillim të vitit 2023 ka vlerën 6,168,858 lekë dhe në mbyllje të vitit ka vlerën 5,251,168 lekë. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendje në 01.01.2023	6,168,858	(-)917,690
Hyrje gjatë vitit 2023	9,729,535	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	10,647,225	
Gjendja në 31.12.2023	5,251,168	

Llogaria 32 “Objekte Inventari”, në fund të vitit 2022 ka vlerën 15,598,784 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 16,629,404 lekë, që përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendja në 01.01.2023	15,598,784	1,030,620
Hyrje gjatë vitit 2023	1,030,620	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	-	
Gjendja në 31.12.2023	16,629,404	

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit". Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik, vlerësimit të aktiveve që klasifikohen të dëmtuara dhe atë të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Nga auditimi *konstatohet se* me përfundimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara, nga ana e SFB në hartimin e pasqyrave financiare nuk është bërë shkarkimi nga kontabiliteti i tyre në llogaritë përkatëse, në moszbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022.

• Inventarizimi i aktiveve

Bashkia Pustec nëpërmjet Urdhrit të Titullarit nr. 143 datë 12.09.2023 dhe me nr. 1169 prot., datë 12.09.2023, janë ngritur komisioni i vlerësimit dhe ai i asgjësimit paraqitur në Aneksin PF5. Nga Auditimi i praktikës dokumentare të inventarizimit *rezulton se*:

- Komisioni i inventarit fizik dhe ai i vlerësimit të aktiveve është i njëjtë, konform nenit 97 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;

- Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit me asgjësim përbëhet nga 5 persona konform nenit 100 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;

- Për vlerësim të pajisjeve IT me njoftimin nr. 1034 prot., datë 08.08.2023 është publikuar "Kërkesa për specialist të jashtëm IT" e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pustec.

Në përgjigje të thirrjes, është lidhur një Akt marrëveshje midis Bashkisë Pustec (pala kërkuuese) dhe Bashkisë Devoll (pala ofruese) me nr. 2747 prot., datë 06.09.2023, konform pikës 101 Kreu IV të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;

- Komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit të aktiveve nuk ka ndarë në dokumente të veçanta Relacionin për inventarizimin fizik të njësisë ku përfshihen edhe inventaret e vlerësuara paraprakisht si të dëmtuara, nga Relacioni i vlerësimit përfundimtar të aktiveve të dëmtuara për nxjerrje jashtë përdorimit, duke sjellë si pasojë që *në 3 raste anëtarë të tij janë edhe në cilësinë e personit përgjegjës të materialeve* dhe konkretisht: zyra e financës, zyra e ndihmës ekonomike dhe zyra e urbanistikës, në kundërshtim me pikën 82 dhe 99 Kreu IV të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;

Komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit të aktiveve ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës në datë 12.09.2023, mbi të cilët është hartuar dhe Relacioni përmbledhës si më poshtë vijon:

Llogaria 218

Destinacioni fundor	Nr	Vlera /lekë
Për asgjesim/groposje	10	677,672.00
Shitje për skrap	35	304,329.29
Totali	45	982,001.29

Llogaria 327

Destinacioni fundor	Nr	Vlera /lekë
Për asgjesim/groposje	189	1,135,309.10
Shitje për skrap	14	79,510.00
Totali	203	1,214,819.10

Totali

Destinacioni fundor	Nr	Vlera /lekë
Për asgjesim/groposje	199	1,812,981.10
Shitje për skrap	49	383,839.29
Totali	248	2,196,820.39

Burimi: Bashkia Pustec/Punoi Grupi auditimit

-Ka një praktikë të plotë dokumentare për aktivet që i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit “me groposje” dhe “për skrap”;

Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit të aktiveve, mbështetur në Relacionin e vlerësimit përfundimtar të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të përpiluar nga komisioni i inventarizimit fizik dhe vlerësimit, ka ndjekur procedurën e asgjësimit të inventarëve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit, ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës në datë 26.09.2023, mbi të cilët është hartuar dhe Relacioni përmbledhës. Kontingjenti i aktiveve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit është klasifikuar në 2 kategori: për asgjesim/djegje-groposje dhe për skrap. Procedurat respektive janë ndjekur konform pikës 107-120, kreut IV të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Rezultatet e procedurës së inventarizimit të aktiveve të përpiluara në Relacionin përmbledhës janë përcjellë në Këshillin Bashkiak për njohje dhe miratuar me Vendimin nr. 64 datë 29.09.2023 dhe me nr. 1233/1 prot., datë 29.09.2023.

- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të njësisë, nuk është hartuar dhe miratuar Regjistri i aktiveve të bashkisë. Nga SFB është hartuar vetëm regjistër elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, përbëhen nga:

- “Llogari të arkëtueshme” për vitin 2023 është në shumën 126,020,217 lekë dhe në vitin 2022 është 25,030,734 lekë me një diferencë prej (-)100,989,483 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së vlerës së llog. 468 “debitorë të ndryshëm” me shumën 4,503,430 lekë për mospagesa ndaj kreditorëve dhe rritjes së llog. 4342 “të tjera operacione me shtetin (debitor)” me shumën 96,486,053 lekë;

- “Të tjera aktive afatshkurtra” për dy vite radhazi 2023 dhe 2022 është në shumën 0 lekë.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2022 është 17,983,048 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 22,486,478 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	17,983,048
Shtesa gjatë vitit 2023	4,503,430
Pakësime gjatë vitit 2023	
Gjendja në 31.12.2023	22,486,478

Llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” ka si kundërparti llog.4341 "operacione me shtetin (detyrime)" dhe duhet të kuadrojë me llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në vlerën 22,486,478 lekë, llogari e cila nuk pasqyrohet me vlerën respektive. Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie ka ardhur në rritje me 4,503,430 lekë në vlerë, për arsye të mos pagesave të taksa e tarifa

vendore nga biznese e nga familjarë⁹. Shuma e detyrimeve debitohej në llog. 468 “debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor)”.

Analiza e detajuar e gjendjes së llogarisë “Debitorë të ndryshëm” (të hershëm), paraqiten në pasqyrën debitorë analitikë në fund të vitit 2023, sipas Aneksit PF7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. Në tabelën pasqyrohen debitorë të hershëm për diçka të 33 këshilltarëve të ish komunave. *Konstatohet* se nga SFB nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS mbi hartimin e një plani për të mundësuar arkëtimin e shumës 129,768 lekë në buxhetin e bashkisë Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 30,933,239 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën 44,230,297 lekë dhe kuadron me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, me një diferencë (2023-2022) prej 13,297,058 lekë; kjo shumë kuadron me shumën e llogarive të pagueshme në pasiv si në tabelë:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	811,918
Detyrime personelit llog.42	3,585,907
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	148,177
Sigurime shoqërore llog.435	1,082,177
Sigurime shëndetësore llog.436	144,658
Organizma të tjerë shtetërorë	0
Kreditorë të ndryshëm llog.467	97,760,903
Totali	103,533,740

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të viteve 2022 dhe 2023 në pasqyrat financiare vjetore paraqitet në vlerën zero (0) lekë referuar Udhëzimit të MFE nr. 5 datë 21.02.2022 i ndryshuar datë 16.03.2022. Nga auditimi dhe dokumentacioni raportues nga ana e DFB Bashkia Pustec në MFE me nr. 1077 prot., datë 23.02.2024, rezulton se: vlera e llog. 486 është 811,918 lekë që përbën detyrimet e prapambetura që bashkia u ka të tretëve për investimet e shërbime etj.

Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019 i ndryshuar, pika 42 ku cilësohet: “Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, “shërbime” apo “investime” të kryera, por të pa financuara”.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. Aktivet afatgjata

Objektivat e auditimit janë që të sigurohemi se: Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 “Pozicioni Financiar”, “Aktivet afatgjata” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 320,290,974 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 625,629,045 lekë dhe që përbën

⁹ Në mënyrë të detajuar te pika 2.6 e programit, rubrika e debitorëve

vlerën e aktiveve të llog.21 "aktive afatgjata materiale"; Tabela përmbledhëse paraqitet në Aneksin PF8 të Projekt Raportit të Auditimit.

Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM):

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, për dy vite radhazi pasqyrohet në vlerën zero(0). Ndërsa sipas Formatit 7/a, b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) & (vlera neto), paraqitet e analizuar si vijon:

Emërtimi i Aktivit Llog. 202	Gjendja më 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2023	Pakësime gjatë vitit 2023	Amortiz. Akum.	Gjendja më 31.12.2022
Studime e projekte	0	0	0	0-	0

Aktivitet afatgjata materiale (AAM):

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale” në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2023 në vlerën 625,629,045 lekë; në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 320,290,974 lekë, me një shtim të AAM-ve me 305,338,071 lekë.

Kjo Llogari sintetike e analizuar paraqitet: nga ndryshimi i llog. 212 nga me një diferencë në rritje 4,159,077 lekë më shumë; në llog. 213 me shumën 304,585,395 lekë; rënie e llog. 214 me shumën (-)20,261 lekë; nga shtimi i llog. 215 me 4,625,253 lekë dhe lëvizjeve në llog.218 me shtime me dhe pa pagesë jashtë sistemit në shumën totale 5,582,998 lekë. Informacion i detajuar paraqitet në tabelën e Aneksit PF9 të Projekt Raportit të Auditimit.

Sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 430,281,695 lekë dhe në fund të vitit 2023 në vlerën 779,894,306 lekë.

Konstatohet se në pasqyrën Format 7/a nuk janë pasqyruar pakësimet e kryera si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuar të dëmtuara nga procedura e inventarizimit vjetor të aktiveve për vitin 2023, në vlerën 2,196,820.39 lekë..

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet në mbyllje të viteve 2022 e 2023 në vlerën zero (0); si dhe në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” paraqitet në të njëjtën vlerë. Kjo llogari ka inventar fizik por nuk ka inventar kontabël.

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 210	Gjendja 31.12.2021	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Toka, troje, terrene	0	0	0	-	0

Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, paraqiten në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në të njëjtën vlerë 1,793,836 lekë dhe kuadron me llog.211 në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata”. Lëvizjet e llog.211 si më poshtë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2021	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Pyje, Plantacione	1,793,836	0	0	-	1,793,836

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 43,471,535 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,630,612 lekë, me një shtim prej 4,159,077 lekë. Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 54,715,489 lekë dhe në fund të vitit 2023 në vlerën 61,973,227 lekë, me një vlerë të shtuar në shumën 7,257,738 lekë që përfaqëson vlerën e investimeve të përfunduara;

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 43,471,535 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,630,612 lekë; Diferenca 4,159,077 lekë përfaqëson vlerën e shtesës duke zbritur vlerën e amortizimit (7,257,738-3,098,661). Llog.212 në pasqyrën F1 kuadron me llog.212 në pasqyrën F7/a e F7/b. Lëvizjet e llog.212 si në tabelën më poshtë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog.212	Gjendja 31.12.2021	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2022		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Ndërtim e Konstruksione	54,715,489	7,257,738	0	14,342,615	47,630,612

Në regjistrin e inventarit të llog.212 “Ndërtesa Konstruksione”, nga verifikimi rezulton se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

Për vitin 2023 nga Bashkia Pustec janë kapitalizuar 2 objekte/bashkëfinancim projekti dhe përmirësim i banesave sociale në vlerën totale 7,257,738 [1,059,174 + 6,198,564] lekë. Analiza e detajuar e llog. 212 paraqitet në Aneksin PF10 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

• Hyrjet e AAGJ dokumentohen:

- Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).
- Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit.
- Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.
- Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto të saj 248,305,612 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 552,891,007 lekë me një shtim në vlerën 304,585,395 lekë; Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 301,375,713 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 637,853,798 lekë, ku diferenca prej 336,478,085 lekë përbën vlerën e investimeve të bëra në vitin 2023;

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 248,305,612 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 552,891,007 lekë; Diferenca 304,585,395 lekë përfaqëson shtesën duke zbritur vlerën e amortizimit (336,478,085- 31,892,690). Lëvizjet e llog. 213 është si më poshtë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2022	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2023		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2023
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore	301,375,713	336,478,085	-	84,962,791	552,891,007

- Në Bashkinë Pustec në llog. 213 të regjistrin të aktiveve, janë 22 objekte inventarë në vlerën totale 637,853,798 lekë. Diferenca në rritje prej 336,478,085 lekë e gjendjes kontabël të vitit 2023, përbën kontabilizimin e investimeve të kryera në vitin 2023: janë 4 objekte të kapitalizuara në vlerën totale 336,478,085 [301,371,258+33,720,070+70,057+1,316,700] lekë;

Në regjistrin e inventarit të llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nga verifikimi rezulton se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël. Analiza e llog. 213 paraqitet në Aneksin PF11 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,682,736 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 13,662,475 lekë me një diferencë prej (-)20,261 lekë; Ndërsa në formatin 7/a paraqitet në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2022 prej 19,119,584 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 23,874,153 lekë. Diferenca prej 4,754,569 lekë përfaqëson vlerën e aktiveve të shtuara nga blerje me pagesë. Lëvizjet e llog. 214 me ndryshimet nga viti 2022 në 2023 paraqitet si në tabelë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 214	Gjendja 31.12.2022	Shtesa dhe pakësim gjatë vitit 2023	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2023
1	Instalime teknike, makineri, pajisje	19,119,584	4,749,769 -	10,211,678	13,662,475

Nga auditimi *rezulton* se në regjistrin e aktiveve të llog. 214 janë në total 57 objekte inventarë në vlerën totale 23,874,153 lekë. Në mbyllje të vitit 2022 janë 43 objekte inventarë në vlerën totale 19,119,584 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 janë 57 objekte inventarë në vlerën totale 23,874,153 lekë. Diferenca prej 4,754,569 lekë është vlara e 14 objekteve inventarë të hyra në vitin 2023.

Në regjistrin e inventarit të llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje”, nga verifikimi *rezulton* se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në *Aneksin PF12* bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Pustec më datë 31.12.2022 në shumën 11,916,196 lekë dhe në 31.12.2023 në shumën 9,651,115 lekë, ku diferenca (-)2,265,081 lekë (rënie) është vlara e amortizimit vjetor. Ndërsa në formatin 7/a lëvizjet e llogarisë janë si më poshtë:

Në lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	11,916,196
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	-
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-
Gjendja në 31.12.2023 (D)	9,651,115

Bashkia Pustec ka në pronësi të saj dhe në gjendje aktive 11 mjete transporti në vlerën totale 110,520,726 lekë dhe në pasqyrën Format 7/a llog.215 “Mjete transporti” gjatë vitit 2023 është si në tabelë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve - llog. 215	Gjendja 31.12.2022	Shtesa dhe pakësim Gjatë vitit 2023	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2023
1	Mjete transporti	45,301,618	0 0	35,650,503	45,306,418

Analiza e detajuar e llog.215 paraqitet në *Aneksin PF13*, bashkëlidhur *Projekt Raportit të Auditimit*.

Llogaria kontabël 218 “*Inventar ekonomik*”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga Bashkia Pustec. Sipas pasqyrave financiare Format 1 dhe Format 7/a, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2022 paraqitet në vlerën 1,121,059 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 0 lekë me një diferencë (pakësim) në vlerën (-)1,121,059 lekë, e cila përbëhet: nga shtesat në shumën 1,122,219 lekë, 760,498 lekë nga lëvizjet brenda sistemit dhe 361,721

lekë nga lëvizjet brenda aktiveve, pakësime 19,298,241 lekë për nxjerrje jashtë përdorimit dhe me amortizim prej 65,427,211 lekë (163,901,410+71,951,683-46,128,970); Lëvizjet në llog.218 sipas Formatit 7/a janë si më poshtë:

Në lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	7,975,455
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	1,122,219
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023 (D)	9,097,674

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve llog.218 dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e mësipërme, *konstatohet se* vlera prej 982,001 lekë që i takon objekteve inventare të kësaj llogarie të dala jashtë përdorimit, *nuk janë pasqyruar* në pasqyrat format 7/a e 7/b në rubrikën pakësime, duke e pasqyruar të mbivlerësuar në shumën 982,001 lekë, kur në fakt duhet të pasqyrohej në shumën 8,115,671.94 lekë. Analiza e detajuar e llog.218 paraqitet në Aneksin PF 14, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Nga auditimi *konstatohet se*:

- Janë regjistruar gabimisht 39 aktive të llojit “fond biblioteke-libra” në vlerën totale 12,650 lekë, të cilat duhej të regjistroheshin në llog.212/nënlllog.2120 “krijim fond biblioteke” me koeficient amortizimi prej 5%. Pra llog. 218 është mbivlerësuar për shumën prej 12,650 lekë.
- Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” rezulton se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndare si nënkategori më vete [2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës së llogarisë dhe regjistrit të inventarëve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

Në pasqyrën Format 7/b llog. 218 “inventar ekonomik” pasqyrohet si më poshtë:

Në lekë

nr	Emërtimi i Aktiveve - llog. 218	Gjendja 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Pakësime gjatë vitit 2023	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Inventar ekonomik	7,975,455	1,122,219	0	9,097,674	9,097,674

Referuar Pasqyrës F7/b vlera neto e AAM në fund të vitit 2022 është 7,975,455 lekë dhe në fund të vitit 2023 është 0 lekë, ku diferenca prej 5,882,998 lekë, përfaqëson vlerën e amortizimeve dhe kostove historike [kosto historike- amortizim i akumuluar].

Llogaria 209&219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” është llogaritur për çdo aktiv sipas koeficientit të amortizimit. Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Pustec në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën bruto 109,990,721 lekë; Amortizimi vjetor gjatë vitit 2023 është në vlerën 44,274,540 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqiten në vlerën neto 154,265,261 lekë, Nga auditimi i analizës së llogarive të klasës 2 (për AAGJM) në regjistrin e aktiveve *rezultoi se* amortizimi është llogaritur për çdo aktiv, duke patur kështu informacion mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero dhe si rrjedhojë patjen nën kontroll të nevojës për rivlerësimin e atyre që janë në gjendje pune, konform udhëzimit nr. 30/2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë publike” Kreu II pika 23/d.

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Pustec, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK. Rezulton se këto asete janë të pa kontabilizuara.

Analize e llog. 209&219 paraqitet në Aneksin PF15, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

25-26 Aktive Afatgjata Financiare në pasqyrat financiare pasqyrohet në vlerën zero dhe përbëhet nga:

Llog. 25 “huadhënie e nënhuadhënie” në vlerën zero;

Llog.26 “ pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila paraqitet në vlerën zero.

Nga auditimi **konstatohet** se Bashkia Pustec në QKB sipas Ekstraktit të datës 13.12.2024 paraqitet si Aksionere me 0.64% UK Pustec sha- tani "Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë" sh.a me NUIS -“M24431001N” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.dhe se vlera e aksioneve vazhdon të mos jetë regjistruar në llogarinë 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” “Numri i aksioneve është 640 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 64,000 lekë, për të cilën llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar.

Pasqyrat statistikore nr. 7/a dhe 7/b “Akivet afatgjata me vlerë neto dhe me kosto historike”

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Pustec, janë si më poshtë:

Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5%

Inventari ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) 20%

Pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%

Mjetet e transportit 20%

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2022, paraqiten në shumën 2,787,307,249 lekë dhe për vitin 2023 në shumën 2,984,911,331 lekë, me një diferencë (shtim) prej 265,664,326 lekë; sipas Formatit 7/a është si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emertimi i Llog	Gjendja fillim viti 2022	Debi	Kredi	Gjendja me 31.12.2023	Diferenca
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0			0	
2	Aktive Aftagjata materiale	2,783,843,161	346,573,043	3,357,929	2,981,447,243	197,604,082
tota		2,787,307,249	346,649,043	3,433,929	2,984,911,331	

Investimet e kryera gjate vitit 2023 që janë në proces referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin keto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit -debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog. 404; në momentin e pagesave –debitohet llog.404 dhe kreditohet llog.520; në fund të vitit ushtrimor për fondet e papërdorura për investimet në proces debitohet llog.476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të papërdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm por të financuara me fondet ë proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit

ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizimi i aktivitetit në debi të llog. 21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog. 231; me kapitalizimin e aktivitetit - debitohet llog. 476 dhe kreditohet llog. 105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog. 105. Pra të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës.

Llogaria 231 “AAGJM, “Investime në proces”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 2,787,307,249 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,984,911,331 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor 2023.

Llogaria 231 “AAGJM, “Investime në proces” si dhe analizën e llog. 466 sipas burimeve të financimit, Formati nr. 6, është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

PASIVET (DETYRIMET):

Pasivet Afatshkurtra: Llogaritë e klasës 4, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., që paraqiten në Aneksin PF 17, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2022 është 1,721,533 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është 811,918 lekë me një diferencë (-)909,615 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e pa likuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Pustec deri më 31.12.2023. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie rezultoi se janë 9 fatura të pa likuiduara në vlerën totale 811,918 lekë analizë e të cilave është paraqitur në Aneksin PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Pustec, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 3,328,068 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,585,907 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 257,839 lekë. Vlera e llog. 42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2022 në vlerën 136,195 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 148,177 lekë me një diferencë (shtim) prej 11,982 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimi mbi pagën.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,007,466 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,082,177 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 133,546 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është pasqyruar 144,657 lekë. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar. Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo

llogari. Nga verifikimi i Urdhër Shpenzimeve të bankës në janar 2024, rezultojnë në vlera të njëjta me atë të llogarive kontabël.

Në lekë

Nr.	Pagat Dhjetor 2023	Paga	Sig.Shoq	Tatimi mbi page
1	Punonjesit e Bashkise në total	3,585,907	1,326,834	148,177

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,134,596 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 25,933,728 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% kontrate në shumën 25,878,728 lekë dhe pulla në shumën 55,000 lekë, të cilat rakordojnë me Akt rakordimin me Degën e Thesarit Korçë.

Në lekë

Numri i investimeve	Gjendje deri më 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakesime nga 2022 në 2023	Gjendje 31.12.2023	Numri
14	9,079,596	16,995,932 / 3	196,800 / 1	25,878,728	15
(5% + pulla)	9,134,596			25,933,728	

Në mënyrë analitike llog.466 është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga analiza e llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” rezulton se nga 18 projekte investimesh në total në vlerën 9,079,596 lekë deri në 31.12.2022, ka disa projekte investimesh për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i plotë përkatës që kryesisht e përbëjnë projektet e transferuara nga ish Komunat. Për këto projekte nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë: GMS, Sektori i urbanistikës dhe Sektori i financës dhe buxhetit nuk është bërë asnjë analizë e situatës për marrjen e masave konkrete për zhbllokimin e kësaj llogarie.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vitin 2023 në shumën 97,760,903 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 146,181,288 lekë me një diferencë në rënie prej (-)48,420,385 lekë. Kjo llogari përfshin faturat e pa likuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh. Kjo llogari përbëhet nga detyrime për shërbimet postare 4 fatura në vlerën 16,443 lekë, 2 fatura për TVSH në vlerën 115,285 lekë, shërbime avokatore 1 faturë në vlerën 48,000 lekë, organizim ëëbinari 1 faturë në vlerën 579,690 lekë, shërbime të tjera 1 faturë në vlerën 52,500 lekë dhe furnizim me ujë Bashkia Pustec 4 fatura në vlerën totale 97,600,335 lekë. Gjendja në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 146,181,288 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 97,760,903 lekë me një diferencë (-)48,420,385 lekë. Kjo diferencë është si rezultat i sistemeve të bëra referuar dhe në zbatim të rekomandimit të lënë nga auditimi i KLSH. Analiza e llog.467 paraqitet në Aneksin PF20.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditorë në vlerën 67,467,157 lekë në mbyllje të vitit 2023 dhe në vlerën 40,042,374 lekë në mbyllje të vitit 2022, me një diferencë (shtim) në vlerën 27,424,783 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Pustec trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me Degën e thesarit Korçë mbi fondet që trashëgohe.

Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”.

Në Aneksin PF 21 paraqitet Pasqyra Format 2/të Ardhurat.

Nga pasqyrat rezultojnë se rubrika e të “Ardhurave” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 122,734,924 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 160,414,260 lekë me një diferencë

(shtim) në vlerën 37,679,336 lekë që tregon për përmirësim të vjeljes së taksave e tarifave. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- Llog. 70 “të ardhura nga taksa e tatime” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 2,207,805 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

nënlllog. 702 “Tatim mbi pasurinë” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 1,107,238 lekë dhe përbëhet nga nënlllog. 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” në shumën 1,100,567 lekë;

nënlllog. 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” paraqitet në vlerën 1,107,238 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, ndriçimit, ndërtesës, zënie hapësire publike, etj;

Konstatohet se të ardhurat nga gjobat dhe kamatvonesat duhet të pasqyrohen në llogarinë përkatëse llog. 709 “gjoba e kamatvonesa”, për të patur një pasqyrim të drejtë dhe të saktë të vlerave për secilën llogari kontabël. Kjo ka sjellë që llog. 709 të jetë nënvlerësuar për shumën 2,037 lekë;

- Llog. 71 “të ardhurat jotatimore” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 4,420,313 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

Llog. 710 “të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në vlerën 1,622,666 lekë dhe përfshin vlerën e nënlllog. 7109 “të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” dhe përbëhet qiraja e një godine dhe e ardhur nga antena celulare;

Llog. 711 “shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” në vlerën 2,797,647 lekë, që përbëhet nga: nënlllog. 7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore” në vlerën e 1,167,990 lekë, nënlllog. 7111 “të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh” në vlerën 780,000 lekë, nënlllog. 7115 “gjoba, kamatvonesa dhe zhdëmtime” në vlerën 849,657 lekë;

- Llog. 72 “Grante korrente” në bilancin e vitit 2023 paraqitet në shumën 153,786,142 lekë dhe përbëhet nga:

llog. 720 “Grant korrent i brendshëm” paraqitet në vitin 2023 në shumën 153,786,142 lekë në të cilën përfshihen:

nënlllog. 7200 “Nga buxheti për NJQP (qendrore)” në vlerën 41,263,197 lekë,

nënlllog. 7204 “Pjesëmarrje në institucione në tatime nacionale” në vlerën 1,675,798 lekë

nënlllog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në vlerën 103,533,739 lekë, e cila kuadron me shumën e gjendjes së llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)”;

nënlllog 7207 “sponsorizime të brendshme (nga të tretë)” në vlerën 7,313,408 lekë;

- Të Ardhura të tjera në pasqyrat e bilancit të vitit 2023 paraqitet në shumën 46,402,996 lekë dhe përbëhet nga:

Llog. 787 “tërheqje nga seksioni i investimeve” paraqitet në shumën 46,402,996 lekë.

Të Ardhurat rakordojnë me Seksionin e Të Ardhurave në Degën e Thesarit Korçë.

Rubrika Shpenzimet paraqitet në Aneksin PF 22

- Llog. 600 “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 51,661,880 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga:

Nënlllog. 6001 “paga personeli i përhershëm” në shumën 39,912,461 lekë;

Nënlllog. 6002 “paga personeli i përkohshëm” në shumën 11,749,419 lekë;

- Llog. 601 “kontribute të sigurimeve” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 8,431,035 lekë , ku rezulton e pasqyruar në dy llogari të veçanta:

nënlllog. 6010 “kontribut i sigurimeve shoqërore” në vlerën 7,572,795 lekë dhe

nënlllog. 6011” kontribut i sigurimeve shëndetsore” në vlerën 858,240 lekë ;

- Llog. 602 “blerje mallra e shërbime” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 16,454,064 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:
- nënlllog. 6020 “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 1,198,479 lekë;
- nënlllog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 1,499,960 lekë;
- nënlllog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 1,200,049 lekë;
- nënlllog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 7,196,513 lekë;
- nënlllog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 997,471 lekë;
- nënlllog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 660,603 lekë;
- nënlllog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 0 lekë;
- nënlllog. 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në vlerën 0 lekë;
- nënlllog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 3,700,989 lekë.
- “Transferime korrente” në pasqyrat financiare të bilancit të vitit 2023 paraqiten në vlerën 16,513,054 lekë, dhe përbëhet nga:
- Llog. 606 “transferime për buxhete familjare e individë” që përfshin nënlllog. 6061 “transfera paguara nga Inst.Tjera e Org.Pushteti. Vendor” në shumën 16,513,054 lekë, për pagesat për PAK, Ndihmë ekonomike, Ndihmë raste emergjente e të ndryshme, ndihmë për fatkeqesi natyrore, etj,
- Llog. 63 “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën (-) 112,930 lekë, e cila kuadron me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;
- Llog. 85 “teprica ose deficiti i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” është në vlerën 67,467,157 lekë dhe përbëhet nga: transfertë e pakushtëzuar e trashëguar në vlerën 16,403,301.47 lekë, transfertë specifike të trashëguara në vlerën 43,233,561.24 lekë dhe të ardhura të trashëguara në vlerën 7,830,294.67 lekë. Kjo vlerë rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kuadron me llog.85 të formatit 1 të bilancit.
- Format 5 “shënime shpjeguese” është plotësuar sipas formatit të miratuar;
- Format 8 “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar saktë, duke dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit.

Tek Format 8 i bilancit Fondi i pagave gjithsej është i barabartë me llog 6001 Paga personeli te Format 2 i Bilancit;

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore te Format 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog 435+llog 436).

Tatimi mbi të ardhurat te Format 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 431).

Për pasqyrën Format 8 janë zbatuar drejt Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, kreu I, II dhe III; Aneksi I.

3.3 Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Bashkia Pustec të ardhurat nga tarifatat dhe taksat vendore i arkëton në zyrat e saj manualisht, pasi në territorin e saj nuk ka banka të nivelit të dytë. Përfundim bëjnë subjektet private (jo në çdo

rast) dhe institucionet të cilat detyrimet për llogari të bashkisë Pustec i kryejnë nëpërmjet sistemit bankar.

1. Veprimet me bankën, u kërkuan këto Urdhër shpenzimi:

USH 2 dt. 09.01.2023	U Sh 3-7 dt.09.01.2023	USH 31 dt. 21.02.2023
USH 45 dt. 07.03.2023	USH 54 dt.15.03.2023	USH 57 dt 15.03.2023
USH 84 dt. 12.04.2023	USH 102 dt. 09.05.2023	USH 106 dt. 09.05.2023
USH 120 dt. 17.05.2023	USH 150 dt. 16.06.2023	USH 174 dt. 11.07.2023
USH 254dt. 05.10.2023	USH 279 dt. 09.11.2023	USH 321 dt. 27.12.2023

Nga auditimi rezultoi se Urdhër Shpenzimet bashkëngjitur përmbanin praktikën e plotë dokumentare sipas kuadrit ligjor në fuqi: dokumenti autorizues, vërtetues dhe të kontabilitetit.

2. Veprimet me arkën Nga auditimi i dokumentacionit për veprimet me arkën rezultoi se:

- Arkëtimet kryhen në zyrën e taksave në bashki në Librat e arkës;
- kryhen akt rakordimet ditore midis arkëtares dhe specialistes së taksave;
Mes specialistes së taksave dhe specialistes së financës;
- Shuma e arkëtuar e lekëve në zyrën e financës *konstatohet se* e kalon vlerën limit të gjendjes së arkës dhe derdhja në bankë nuk bëhet brenda ditës, por duke grumbulluar arkëtimet e javës, duke riskuar kështu sigurinë e cash në ambientet e bashkisë;
- Zyra e financës përpilon ditarin dhe librin e pagesave;
- Akt rakordim mes zyrës përgjegjëse së taksave (sipas llojit) me Sektorin e të Ardhurave Vendore;
- Akt rakordim mujor mes Sektorit të financës dhe Sektorit të Taksa e Tarifave vendore

Gjithë dokumentacioni i mësipërm përmban nënshkrimin e personave përgjegjës të secilës procedurë. Mosveprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” KREU III paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe atyre me vlerë” pika 61-72.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës, *rezultoi se* të ardhurat nga arkëtimet e kryera janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit është zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuarat janë bërë derdhje në bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e Thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës, i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Në zbatim të pikës 3.4 të programit të auditimit, “Mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës” u shqyrtua dokumentacioni me zgjedhje i vënë në dispozicion nga Bashkia Pustec, në lidhje me listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në Bashkinë Pustec, listat shtesë të objekteve të inventarizuara dhe të miratuara me

vendim të Këshillit Bashkiak si dhe procedurat e ndjekur për inventarizimin dhe regjistrimin në DV ASHK, Korçë, si vijon:

1-VKM nr. 103 datë 03.02.2008 “Miratimi i listës të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Liqenas të Qarkut Korçë”. e cila fillon me nr.1 dhe përfundon me nr. 148 prona, në 12 fusha përdorimi.

2-VKM nr. 48 datë 26.01.2022 “Miratimi i transferimit në pronësi të Bashkisë Pustec ,3 pasuri (asete) në zonën kadastrale 2462 dhe 1797”, sipas lidhjes 1, formularëve dhe planeve të rilevimit për:

a-Pasurinë nr. 358/7 me sip. totale 140 m² (ish-vatër kulture Fshati Gollomboc) Kulturë.

b-Pasurinë nr. 278 me sip. totale 2340 m² (qendra shëndetësore Bashkia Pustec) Shëndetësi.

c-Pasurinë nr. 357/1. me sip. totale 810 m² (shkolla fillore S,S. Fshati Gollomboc) Arsim.

3-VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Miratimi i transferimit në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit për Bashkinë Pustec” (shtojca 35 me nr. 1 deri në 11 pasuri me sip. totale prej 708.8 ha (272,4 ha).

4-VKM nr. 1008 datë 30.12.2015 “Miratimi i transferimit nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë të infrastrukturës të ujitjes dhe kullimit të personelit dhe aseteve të luajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, (sipas tabelës nr.1, nga 1 deri në 9 pasuri).

5-VKB nr. 10, datë 24.02.2022 "Për miratimin e listës shtesë të 4 pronave në fushën e infrastrukturës vendore, e konfirmuar nga institucionit i Prefektit.

6-VKB nr. 40, datë 24.08.2022 "Për miratimin e listës shtese të 22 pronave të bashkisë, në fushën Bujqësi dhe Ushqim e konfirmuar nga institucionit i Prefektit.

7- Regjistri i inventarizimit të pronave të bashkisë, (përmbledhëse).

8- Regjistri i pronave në proces aplikimi.

9- Korrespondenca që bashkia ka ndjekur me institucionet e linjës.

10-Urdhër i Kryetarit të Bashkisë “Mbi ngritjen e grupit të punës”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, konstatohet se:

Në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Pustec mungon sektori i menaxhimit të aseteve, por kjo detyrë i është ngarkuar Grupit Teknik të Punës i ngritur me *Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 “Mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec” ndryshuar me Urdhër nr. 149 prot., datë 27.09.2021 (zëvendësimi i një anëtari të larguar) ndryshuar me Urdhër nr. 147.datë 17.08.2022 (për zëvendësim të një anëtari)*

1.1. Inventarizimi dhe transferimi pronave të paluajtshme publike në juridiksionin e Bashkisë Pustec.

Bashkia Pustec brenda juridiksionit të tij nuk ka të përfshirë Njësi Administrative, që do të thotë se miratimi i listës të pronave të paluajtshme publike me VKM, është vetëm për Bashkinë Pustec e cila transferimi në pronësi të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Pustec është miratuar me VKM nr. 48 datë 26.01.2022 vetëm për 3 pasuri, gjithashtu me VKM nr. 433 datë 08.06.2016 janë transferuar në pronësi të Bashkisë Pustec, Pyje dhe Kullota publike sipas listave të inventarit (shtojca 35 me nr. 1 deri në 11 me sip. totale prej 708.8 ha. nga këto vetëm 272.4 ha i përkasin Bashkisë Pustec dhe me VKM nr. 1008 datë 30.12.2015 është transferuar nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë të infrastrukturës të

ujitjes dhe kullimit të personelit dhe aseteve të luajshme të Bordeve Rajonale të Kullimit, (sipas tabelës nr.1, nga 1 deri në 9 pasuri).

Numri i pronave të Bashkisë Pustec të transferuara dhe të miratuara me VKM janë vetëm 19 pasuri, ndërsa 143 pasuri të miratuar me VKM plus 12 pasuri me lista shtesë të miratuar me VKB, janë në proces transferimi me VKM që do të dërgohen nga ASHK-ja.

Në lidhje me ***mos miratimin e*** listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të *Bashkisë Pustec* për të cilën është miratuar vetëm lista e inventarit të pronave të paluajshme shtetërore me VKM nr. 103 datë 03.02.2008. rezulton se:

Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Pustec nr. 166 datë 31.10.2019 i ndryshuar, nga Grupi i Punës, është ndjekur procedura në bazë të udhëzimeve të ligjit organik deri në përfundimin e miratimit të listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajshme shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrative të Bashkisë Pustec sipas listës të inventarëve të pronave të paluajshme të miratuara me VKM nr.103, datë 03.02.2008 si dhe listave shtesë të objekteve të inventarizuara dhe të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak.

Në lidhje me VKM nr. 103 datë 03.02.2008 ku është miratuar vetëm lista e inventarit të pronave të paluajshme shtetërore në komunën Liqenas të Qarkut Korçë, e cila fillon me nr. 1 dhe përfundon me nr. 148 prona, në 12 fusha përdorimi, në të gjithë zinxhirin e procedurës të listës të inventarit të pronave që duhen të transferohen, nga Bashkia Pustec janë mbajtur një sërë korrespondencash fillimisht me Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (Ministria e Brendshme) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ku me hyrjen në fuqi të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” ish-Agjencia e Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike është shkruar dhe praktikat në proces të ndjekura prej saj janë vijuar bazuar në pikën 3 të nenit 67 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” ku kompetencat e Agjencisë së sipërcituar i janë ngarkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë për vijimin e procedurës nga ASHK-ja është kërkuar në sërë dokumentesh për të cilën për disa prej kërkesave, nga Bashkia Pustec është e pamundur nga ana financiare që të plotësohen, për faktin se për çdo informacion që kërkohet nga Bashkia Pustec për statusin juridik për të gjithë pronat e kërkuara nga DV ASHK Korçë, kërkohet pagesa e tarifës së shërbimit dhe përgatitja për çdo pasuri e një plan rievitimi, që do të thotë se për bashkinë Pustec është një kosto e shtuar dhe pothuajse e pa përballuar nga buxheti që kjo bashkia ka, në zbatim të pikës 1 germa “g” i nenit 67 të ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. g) “tarifa për regjistrimin e pronave shtetërore të pushtetit qendror apo të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Nga ana e bashkisë është vijuar procedura për transferimin e 43 pronave që kanë lidhje me VKM nr. 103 datë 03.02.2008, për të cilën është kryer aplikimi me datë 08.05.2024 për kartelet dhe harte treguese në DV ASHK Korçë, për statusin juridik të pronës ku për këto 43 pasuri pritet të hapet procedura e tenderit “Për hartimin e Plan-Rievimit”.

Bashkia është në proces transferimi me procedurë të përshpejtuar për 12 prona nga të cilat 8 prona bëjnë pjesë brenda Zonës së Mbrojtur dhe që nuk janë të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Konkluzion: Bashkia Pustec (Sektori i Financës) nuk ka parashikuar dhe përlogaritur në buxhet kostot e nevojshme për pagesa e tarifës për përgatitjen e plan rievitimit për 148 pasuri pronë publike që do të dorëzohen pranë DV ASHK Korçë, për të bërë të mundur transferimin në pronësi të bashkisë Pustec me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin

e kësaj Bashkie përcaktuar në prioritetet e investimeve dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në zbatim të pikës 1.2/a të nenit 9 dhe me piken 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Lidhur me VKM nr. 103 datë 03.02.2008 ku është miratuar vetëm lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Liqenas të Qarkut Korçë, si dhe listat shtesë të objekteve të inventarizuara dhe të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak, pranë protokollit të bashkisë ekziston e gjithë korrespondenca që në vitin 2018 dhe deri në vitin 2024 që bashkia ka ndjekur me institucionet e linjës për mundësimin e transferimit e disa pronave si pjesë e listës emergjente të pronave të bashkisë, që nga bashkia është kërkuar një procedurë e përsheptuar nga ana e ASHK-së për efekt të përdorimit emergjent të disa pronave në funksion të investimeve që po kryen bashkia Pustec përcaktuar në prioritetet e investimeve për bashkinë.

E gjithë korrespondenca e ndjekur nga grupi teknik i punës për këtë procedurë ka qene e bazuar mbi ligjet dhe VKM respektive dhe konkretisht:

- Ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave te paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

- VKM nr. 500 datë 14.08.2001 ”Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore.

- Udhëzimi nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësite e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike dhe të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur ;

- Ligji 111/2018 “Për kadastrën“ ku të gjitha funksionet e Agjencisë të Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i kalojnë strukturës të re Agjencia Shtetërore të Kadastrës (ASHK)

- Ligjit 20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

- VKM nr. 782 datë 07.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrave dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

Korrespondenca nga 2018 dhe në vazhdim

- *Shkresa e Bashkisë Pustec nr. 571 prot., datë 8.11.2018 (drejtuar ASHK) (kërkese për miratimin e listës paraprake).

- *Përgjigje shkrese e M. Bujqësisë me nr. 10435/6 prot., datë 4.2.2019 (kërkese për reflektim.....

- *Përgjigje e bashkisë drejtuar MB me shkrese nr. 131/1 prot., datë 22.2.2019 (Dërgojmë listën e pronave në fushën e B/U dhe U/Kullimit.

- *Përgjigje M. Bujqësisë me shkrese nr. 2812 prot., datë 2.4.2019 (Mbi ndryshimet në VKM nr. 1108 datë 30.12.2015 “Për inventarin e skemës të ujitjes ...)

- *Përgjigje e bashkisë drejtuar M. Bujqësisë me shkresa

- * a-305/5 datë 28.5.2019 (dërgojmë për konfirmim ndryshimin dhe propozimin e inventarit UK.... Sipas VKM ...

- *b-305/8 datë 31.5.2019 (Lista e pronave sipas transferimit se bashku me miratimin e Prefektit (me shkrese nr. 778/1 prot., datë 30.5.2019, dhe bordit të kullimit me shkrese nr. 239/1 prot., datë 25.5.2019.

*Shkresë e bashkisë drejtuar AKSH nr. 1282 prot., datë 12.12.2019 kërkesë për miratim të listës paraprake të pronave (121 prona)

*Përgjigje e ASHK drejtuar bashkisë me shkresë nr. 19751 prot., datë 23.12.2019 (sugjerim baza ligjore e Planeve të rilevimit ...).

*2020/1*bashkia i drejtohet ASHK me shkresë nr. 524 prot., datë 26.5.2020 (kthim përgjigje e shkresës 19751 prot.

2020/2* bashkia i drejtohet ASHK me shkresë nr. 1104 prot., datë 1.10.2020 kërkesë për procedure të përshpejtuar (të 8 pronave).

*Përgjigje e ASHK-drejtuar bashkisë me shkresë nr. 14889 prot., datë 14.10.2020 (kthim përgjigje e Sh 1104).

*ASHK dërgon shkresë bashkisë 4152 prot., datë 4.6.2021 kërkesë për bashkëpunim (shoqëruar me shkresat 3575 prot., datë 27.5.2021 e zëvendëskryeministrit dhënie mendim, për 8 pronat.

* (2021/1) bashkia i dërgon ASHK shkresë me nr. 79 prot., datë 20.1.2021 prap kërkesë për procedure të përshpejtuar (me ndryshimet e udhëzimit).

*2021/2- bashkia dërgon shkresë ASHK me nr. 259 prot., datë 26.02.2021 (ridërgim dokumentacioni të shkresës nr. 79 prot., datë 20.1.2021).

*2021/3 bashkia dërgon shkresë nr. 553 prot., datë 29.4.2021 (kërkesë për vazhdim të procedurës për 3 pasurit e miratuar (hiqen 5 pasuri të fushës të bujqësisë, mos dekoruesi e ministrisë të mjedisit)

*2021/4 bashkia dërgon shkresë ASHK nr. 725 prot., datë 7.6.2021, kërkim për vazhdim procedure.

*-2022/1- shkresa nr. 147 prot., datë 31.01.2022 (erdhi VKM nr. 48.26.01.2022. “Për transferimin në pronësi të bashkisë Pustec të disa pasurive (3 tre) pasuri.

-*2022/2 shkresa nr. 180 prot., datë 03.02.2022 kërkesë për transferim prone nr.1291 ish-repart ushtarak fshati Kallamas drejtuar Ministrisë të Mbrojtjes).

-*2022./3 shkresë nr. 505 prot., datë 04.04.2022 ridërgim i shkresës ARZM Korçë.

-*2022/4 shkresa nr 734 prot., datë 18.05.2022, (kërkesë për kalim në pronësi të bashkisë Pustec të pasurisë nr. 87 ish-repart ushtarak (fshati Kallamas) drejtuar Ministrisë të Brendshëm.

-*03.02.2022 Aplikime ne sistemin e-albania – (për certifikatë pronësie për tre pronat të dala me vkm nr 48 ...)

-*12.10.2022 Aplikim në sistem për harta treguese dhe kartelet për 14 prona emergjente (shtese në fushën e bujqësisë).

Është në përpunim procedura për aplikim pranë ASHK, për miratim të listës të 12 pronave emergjente (kalim në pronësi të bashkisë Pustec).

1-Shkresen nr. 158 prot., datë 01.02.2023 e bashkisë Pustec drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2-Shkresen nr. 4114 prot., datë 20.02.2023 e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës drejtuar bashkisë Pustec.

3-Shkresen nr. 1410 prot., datë 31.10.2023 Kërkesë për miratim : e bashkisë dërguar Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit .

4-shkresa 1411 prot., datë 31.10.2023 ridërgojmë kërkesë për të kryer procedurat e transferimit për 12 prona të bashkisë Pustec. dërguar ASHK.

5-Shkresen nr. 569 prot., datë 05.02.2024 e Ministrisë të Turizmit drejtuar bashkisë Pustec.

Shkresat përcjellëse të sipërcituara janë të shoqëruara me të gjitha dokumentacionin e përshkruar në to, dhe janë të arkivuara në bashki.

Për sa më sipër, nga ana e Bashkisë Pustec në zbatim të nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.SH”, është kryer përditësimi i plotë i pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre. Nga grupi teknik i punës është verifikuar gjendja faktike e pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, gjithashtu nga bashkia është kërkuar në DV ASHK Korçë, informacion i plotë për gjendjen juridike të pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj, bazuar në aplikimet e bëra në portalin e-albania.

Nga ana e ASHK-së nuk është shqyrtuar përputhshmëria e listës së pronave shtetërore, të përcjellë nga bashkia, që do të thotë së nga ana e ASHK-së nuk është njoftuar bashkia në lidhje me aplikimet e bëra për pasuritë me procedure të përsheptuar.

Nga grupi teknik i punës janë krijuar 2 regjistra të pronave konkretisht:

1-Regjistri i inventarizimit të pronave të bashkisë, (përmbledhëse).

2-Regjistri i pronave në proces aplikimi :

a-Për pasuritë të cilat janë transferuar (subjekt i VKM nr. 48) aplikohet për certifikatë pronësie (që janë në proces)

b-Për pasuritë të cilat duhet të transferohen në pronësi të bashkisë (subjekt i VKM nr. 103 i përditësuar) aplikohet për kartelet dhe hartë treguese të pasurisë, konkretisht:

Regjistri i inventarizimit të pronave të transferuara dhe në proces inventarizimi (përmbledhës).

Nr.	Fusha e përdorimit të pronës	Nr. rendor Fillim – mbarim	Nr. i pronave gjithsej	Lista me VKM nr. 48	Shtese të pronave me VKB	Të ndryshme
1	Arsimi	1.2.3.4.5.6.7.8.9	9	357/1 (Sh SS-Gollomb)	0	
2	Kulture – Sport	10.11.12.13.14.15.16.17.18.	9	358/79(V kul Gollomb	0	
3	Infrastruktura vendore	19.20.21.22.23.24.25.26.27// 28.29.30.31.	21		28.29.30.31	Shtesë e fundit
4	Shërbimi funeral	32.33.34.35.36.37.38.39.40	9			
5	Infrastruktura rrugore	41.42.43.44.45.46.47.48.49 .50.51.52.53.54.55.56.57	17			
6	Bujqësi dhe Ushqim	58.59.60.61.62.63.64.65.66. 67.68.69.70.71.72.73// 74.75.76.77.78.79.80.81.82. 83.84.85.86.87.88.89.90.91.92	51		74.75.76.77.78 .79.80.81.82. 83.84.85.86.87. 88.89.90.91.92	
7	Ujitja &Kullimi	93.94.95.96.97.98.99.100	8			
8	Mbrojtja kombëtare	101.102.103	3			103/kërkesa M.M
9	Furnizimi me ujë	104.105.106	3			
10	Energjetike	107.108.109.110.111.112. 13.114.115	9			

11	Shëndetësia	116.117.118.119.120.121. 122.123.124	9	278 (Q.SH Pustec)		
12	Skema e ujitjes	1.2.3.4.5.6.7.8.9	9	Kaluar me vkm 1108	Dt. 30.12.2015	Nga M.B- B. Pustec
13	Pyjet & kullota	11.12.1.2.5.6.7.8.16.134.136	11 (7)	Kaluar me vkm 433	Dt. 08.06.2016	

Burimi: Bashkia Pustec

Në lidhje me pasuritë pyll dhe kullotë bashkiak rezultoi se, me VKM Nr. 433 datë 8/06/2016 është transferuar në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, një sipërfaqe prej 706 ha Pyll dhe Kullote ku mbas azhurnimit në teren rezulton se edhe ky fond nuk është i gjithë për Bashkinë Pustec, por nga 706 ha:

185.8 ha i përket Bashkisë Devoll, “Ekonomisë pyjore Bilishtit”.

208 ha i përket Bashkisë Maliq, “Ekonomisë pyjore të Maliqit”.

Ndërsa sip. prej 44.6 ha ndodhet brenda Zonës Qendrore të Parkut Kombëtar (e cila nuk mund të shfrytëzohet prej bashkisë).

Në këto kushte të transferuar në pronësi të Bashkisë Pustec janë vetëm 272.4 ha, nga këto:

31.8 ha pyll (i degraduar) që i përket ekonomist pyjore Liqenas)

240.6 ha kullota, ekonomisë pyjore Mal i Thatë.

Në lidhje sa më sipër e gjithë kjo sipërfaqe prej 272.4 ha pasuri pyll dhe kullote e miratuar me VKM Nr. 433 datë 8/06/2016 e transferuar në pronësi të bashkisë Pustec është brenda territorit të Zonës së Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.1999.

Pra bashkia është në proces saktësimi të pronës të saj një problematike që po vazhdohet të kërkohej në institucionet qendrore; (për këtë arsye bashkia Pustec nuk mundet të kryejmë asnjë veprim për sa kohë nuk është saktësuar pronësia nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura).

Gjithsej nga lista e inventarit të bashkisë të përditësuar në total janë 186 prona në të gjitha fushat që janë në proces dhe që priten të transferohen me VKM.

Bashkia është në proces transferimi për listat shtesë të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak (me procedure të përshpejtuar për 12 prona, nga të cilat 8 prona nuk janë miratuar nga Ministria e Turizmit për arsye të vendndodhjes brenda zonës të mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës).

Konkluzion: Edhe pse në emër të Bashkisë Pustec janë transferuar me VKM nr. 433 datë 8/06/2016 një sipërfaqe prej 272.4 ha pasuri Pyll dhe Kullote, nga ana e bashkisë nuk është bërë e mundur shfrytëzimi apo tjetërsimi i kësaj sipërfaqe për faktin se e gjithë sipërfaqja është brenda territorit të Zonës së Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës, miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.1999, ku nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura edhe pse ka një kërkesë nga bashkia nuk është kthyer një përgjigje për saktësimin e pasurive, për të bërë të mundur që Bashkia Pustec të ketë mundësi shfrytëzimi dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

1.2. Regjistrimi i pronave të paluajtshme publike në emër të Bashkisë Pustec, në DV ASHK Korçë.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga 19 pasuri që janë miratuar me VKM në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose

në përdorim, brenda juridiksionit të Bashkisë Pustec, është aplikuar vetëm për 3 pasuri për pajisje me certifikatë pronësie, pranë DV ASHK Korçë, konkretisht:

Regjistri i pronave në proces aplikimi për certifikatë pronësie (që janë në proces).

Nr.	Prona të kaluara në pronësi të bashkisë me VKM nr. 48 datë 26.01.2022. Përdorimi & Nr. Pasurie	Nr i aplikimit E-Albania për certifikatë pronësie	Nr, i protokollit dorëzim dokumentacion në DV ASHK Korçë
1	Kulture; NR -358/7 (ish vatër kulture Gollomboc)	2535 datë 3.2.2022	1245 datë 20.9.2022
2	Arsimi: Nr 357/1; (shkolla fillore S.S. Gollomboc)	2541 datë 3.2.2022	1247 datë 20.9.2022
3	Shëndetësi . Nr 278 (qendra shëndetësore Pustec)	2544 datë 3.2.2022	1246 datë 20.9.2022

Burimi: Bashkia Pustec

Për sa më sipër nga bashkia Pustec është aplikuar në portalin e-albania me datë 03.02.2022 për pajisjen me certifikatë pronësie vetëm për 3 pasuri të përfituara me VKM nr. 48 datë 26.01.2022, kanë kaluar mbi 2 vjet dhe nga ana nga DV ASHK Korçë, nuk është bërë e mundur që për këto 3 pasuri, Bashkia Pustec të pajiset me certifikatë pronësie, veprime në kundërshtim me nenin 17 pika 1 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Për 16 pasuri të tjera që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, brenda juridiksionit të Bashkisë Pustec, të miratuar me VKM nr. 433 datë 08.06.2016 dhe me VKM nr. 1008 datë 30.12.2015 nuk është aplikuar nga ana e bashkisë.

Konkluzion: Në juridiksionin e Bashkinë Pustec **janë gjithsej 19 pasuri** të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM, nga këto të aplikuar për pajisje me certifikatë pronësie në DV ASHK Korçë **janë vetëm 3 pasuri**, ndërsa për **16 pasuri nuk është aplikuar**, që do të thotë që për këto pasuri nga Bashkia Pustec nuk është përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Korçë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.SH”.

Për pasuritë të cilat duhet të transferohen në pronësi të bashkisë (objekt i VKM nr. 103 dhe të disa pasurive shtesë të miratuar me VKB si prona emergjente) nga ana e Bashkisë Pustec është aplikuar në e-albania për kopje kartelet dhe harte treguese për statusin juridik të pasurisë, procedurë që ndiqet deri në transferim dhe miratim me VKM nga DV ASHK Korçë, është sipas tabelës:

Nr.	Prona emergjente për aplikim në ASHK (VKM 103 datë 3.2.2008, Shtesat	Nr. i aplikimit për harte treg + kartel
1	Infrastrukturë vendore Nr -285/21(zyrat e bashkisë)	Me aplikim në datë 28.9.2022 Me plan rilevimi
2	Nr-285/25(ish zyrat e kopër bunker)	Me aplikim: Mungon Plan Rilevimit
3	Nr -274/6(ish posta)	Me aplikim, me Plan Rilevimit
4	Nr-301/3(ish godinë kopër Goric e vogël)	Me aplikim, me Plan Rilevimit

5	Fusha bujqësi ushqim Nr-672/2 (are), Lajthize	Me aplikim me Plan Rilevimit
6	Nr-83 (PF) Kallamas	Pa aplikim, me Plan Rilevimit
7	Nr-84 (Are) Kallamas	Pa aplikim, me Plan Rilevimit
8	Nr-95(shkëmb)Kallama	Me aplikim; Mungon Plan Rilevimit
9	Nr-105 (are) Kallamas	Me aplikim: Mungon Plan Rilevimit
10	NR-3/6 (are) Kallamas	Me aplikim: Mungon Plan Rilevimit
11	Nr 2/56 (are)Gorice	Me aplikim, Po Plan Rilevimit
12	Nr-27/11 (are) Gorice	Me aplikim, Po Plan Rilevimit
13	Nr-224(pemëtoje)Pustec	Me aplikim, Po Plan Rilevimit
14	Nr-225(shkëmb) Pustec	Me aplikim, Po Plan Rilevimit

Burimi: Bashkia Pustec

Bashkia Pustec në aplikimet e bëra në DV ASHK Korçë, ka ndjekur procedurat si vijon:

-Me shkresën nr.1411 prot., datë 31.10.2023 “Kërkesë për transferimin e 12 pronave (pasurive) të Bashkisë Pustec” ku i është bashkëlidhur ky dokumentacion:

1. VKB nr. 10, datë 24.02.2022 "Për miratimin e listës shtesë të 4 pronave në fushën e infrastrukturës vendore, e konfirmuar nga institucionit i Prefektit.
2. VKB nr. 40, datë 24.08.2022 "Për miratimin e listës shtese të 22 pronave të bashkisë, në fushën Bujqësi dhe Ushqim e konfirmuar nga institucionit i Prefektit.
3. Harta treguese + kartelat e 12 (dymbëdhjetë) pasurive.
4. Planet e rilevimit për 12 pasuritë, si mbas formatit të kërkuar.
5. Formati elektronik 2 CD (sipas fushës të përdorimit, 1 në fushën e infrastrukturës vendore, 4 pasuri, 1 në fushën e bujqësisë dhe në fushën e ushqimit 8 (pasuri) janë dërguar me shkresën nr. 1499 prot., datë 09.11.2022.

Për sa më sipër, edhe pse nga ana bashkisë është paraqitur e gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor për regjistrim e 12 pasurive në DV ASHK Korçë nga ana e kësaj të fundit nuk është bërë e mundur regjistrimi për faktin se nuk ka përfunduar procesi i transferimit të plotë, që duhet të miratohen me VKM, me ndryshimin e ligjit grupi teknik i punës duhet të plotësoj kërkesat që janë kërkuar nga ASHK dhe arsyeja tjetër është sikur i citua më lart është mungesa e një fondi i cili nevojitet për këtë procedurë që duhet të ishte parashikuar nga bashkia, për certifikimin e pasurive me kryesorë të bashkisë në fusha të ndryshme.

Konkluzion: Nisur sa më sipër duke qenë se ky është një proces në vazhdim për të gjitha pasuritë e juridiksionit të bashkisë si nga përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor ashtu edhe e përgatitjes të listës së inventarit të bashkisë të përditësuar, nga ana e grupit të punës (part time) i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nuk ka qenë e mundur përballimi i këtij procesi voluminoz të inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme publike në juridiksionin e Bashkisë Pustec, që do të thotë se puna e grupit teknik të punës nuk ka qenë efiçente, duke mos përmbushur detyrimet e përcaktuar në urdhrin e kryetarit.

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni me zgjedhje i vënë në dispozicion nga Bashkia Pustec si vijon:

“Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, në Bashkinë Pustec.

-Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

-Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

-Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në Bashkinë Pustec, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

-Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 1028/7 prot., datë 05.02.2024.

-Korrespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Pustec dhe KLSH.

-Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve, etj.

Nga verifikimi rezultoi që:

-Bashkia Pustec, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Bashkia Pustec, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dh dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 20, datë 05.02.2024, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1028/7 prot., datë 05.02.2024, verifikohet se:

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, Kryetari i Bashkisë Pustec me vendim nr. 2, datë 12.02.2024, ka hartuar Plan-Veprimin “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”. Sipas plan-veprimit dhe urdhrave përkatës, janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j.

Me shkresën nr. 266 prot., datë 20.02.2024 nga Bashkia Pustec është dërguar në KLSH vendimi nr. 2, datë 12.02.2024, dhe Plan-Veprimi nr. 217 prot., datë 12.02.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja”, duke kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve. Për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 249 prot., datë 16.02.2024 është raportuar në Këshillin Bashkiak.

-Në lidhje me kthim përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga Bashkia Pustec, nuk është kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, referuar ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe nuk janë marrë masa për respektimin e afatit 6 mujor për raportimin në KLSH-së me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të

rekomandimeve, referuar ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë 13 rekomandime gjithsej, nga të cilat 11 Masa Organizative dhe 1 masë për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) si dhe 3 Masë Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga masa organizative të rekomanduara gjithsej 11, 7 janë zbatuar plotësisht dhe 4 janë në proces zbatimi.

-Nga 1 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) e rekomanduar, është zbatuar.

-Nga 3 masë disiplinore, rezulton të pa zbatuar të 3 masat.

-Bashkia Pustec, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve. Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 61.5 %.

Nr. Rekomandime	Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Pa zbatuar	Pjesërisht/proces	Shpërblim dëmi	Realizimi
13	13	0	7	2	4	0	61.5 %

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit me atributet e Kryetarit të GMS, të marrë masa të menjëhershme, që të njohë punonjësit me aktet ligjore e nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

- Të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.

- Të ndjekë me rigozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit:

Me urdhrin Nr. 64, datë 03.04.2023 të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur një grup pune për të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se kryetari i Bashkisë Pustec, z. P. K. ka ngritur grupin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin me Urdhrin nr. 64, datë 03.04.2023, prot., me nr. 491, datë 03.04.2023, me përbërje: z. J. A nëpunës autorizues/koordinator i MFK, z. C. N., me detyrë përgjegjës finance dhe znj. M. J., me detyrë specialiste finance. Me urdhrin nr.160 datë 09.10.2023, me nr. 1320 prot., datë 08.10.2023, Kryetari i Bashkisë Pustec ka ndryshuar përbërjen e këtij grupi duke përfshirë: z. A. P. nëpunës autorizues

(koordinator i MFK), z. C. N., me detyrë përgjegjëse finance dhe znj. M. J., me detyrë specialiste finance.

Nga verifikimi i dokumentacionit nuk u konstatua nxjerrja e përgjegjëseve për mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm të evidentuar në auditimin e mëparshëm si dhe nuk provohet ndjekja e aplikimit dhe zbatimit të komponentëve të MFK.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi është në proces zbatimi.

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për kryerjen e auditimit nga struktura e auditit të Bashkisë Devoll për veprimtarinë ekonomiko-financiare, referuar Marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Devoll.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Bazuar në Akt Marrëveshje e lidhur me palë Bashkinë Devoll, janë marre masa për kryerjen e auditit të brendshëm për vitin në vazhdim bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga dy titullarët e Bashkisë Pustec dhe Bilisht.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë e menaxhimit të Bashkisë Pustec, u konstatua se kjo njësi vendore ka lidhur me shkresën me nr. 1326 prot, datë 10.10.2023 një Akt Marrëveshje me palë Bashkinë Devoll, për realizimin e auditimit të brendshëm në Bashkinë Pustec. Pavarësisht lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Devoll, për vitin 2023 nuk është kryer auditim mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare në Bashkinë Pustec, por për vitin 2024 është ushtruar auditim i brendshëm nga Bashkia Devoll.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi është në proces zbatimi.

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë reale dhe të argumentuar, si dhe të parashikohet mbulimi me fonde i detyrimeve të prapambetura. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Të përgatiten dhe të paraqiten pranë Këshillit Bashkiak raportet e monitorimit periodik të realizimit të buxhetit, për matjen e performancës financiare, realizimin e produkteve dhe objektivave për çdo program të përcaktuar në vitin ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, nga Sektori i Financës dhe menaxheret e programeve janë marrë masa për kryerjen një procesi planifikimi të buxhetit sa më real dhe të argumentuar për përdorimin me eficient i burimeve financiare, për rritjen e të ardhurave si dhe përgatitja dhe raportimi i raporteve 4 mujore të monitorimit të realizimit të buxhetit për matjen e performancës financiare.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i financës u konstatua se

janë marrë masa për kryejnë e një procesi planifikimi të buxhetit sa me real si dhe përgatitja dhe raportimi i raporteve 4 mujore të monitorimit të realizimit të buxhetit për matjen e performances financiare .

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **është në proces zbatimi**.

4.1 Rekomandimi: Sektori i Financës, Bashkia Pustec në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara të shtetit/bashkia ndaj të trentëve në llogarinë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”, duke përfshirë detyrimet të gjitha detyrimet për paga, sigurime, tatime ndaj punonjësve dhe detyrimet e lindura ndaj të trentëve për fatura të papaguara në fund të vitit ushtrimor.

Deri me datë 31.03.2024

Përgjigjja e institucionit:

Është mbyllur, gjë që është pasqyruar dhe me mbylljen e pasqyrave financiare për 2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i financës u konstatua se janë marrë masa për të kryer kontabilizimin e detyrimeve të lindura ndaj të trentëve në llogarinë 4342.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **është zbatuar**.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të jetë i kujdesshëm në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet të evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në pagesën në vlerë të plotë. Pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Deri me datë 31.03.2024

Përgjigjja e institucionit:

Gjate mbylljes vjetore (të bilancit kontabël) në pasqyrat në shtesat dhe pakësimit e aseteve gjithmonë kemi pasqyruar vlerën e investimit në masën e likuidimit të tij, për rrjedhojë edhe nga ana e degës së thesarit është ndjekur kjo praktike në mbylljen e llogaris vjetore, se vetë likuidimi i investimit është pasqyruar si shpenzim në hartimin e llogaris vjetore.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i financës u konstatua se janë marrë masa që pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizohen në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **është zbatuar**.

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës, Bashkia Pustec të llogarisë në mënyrë të saktë amortizimin e aktiveve të llog.218 “Inventar ekonomik” sipas normave ligjore dhe të kryejë veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse. Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023 të ketë në konsideratë veprimet rregullta në llogaritjen e amortizimit vjetor si dhe të

reflektojnë ndryshimet si rrjedhojë e korigjimeve të kryera për efekt të mbylljes së vitit ushtrimor 2022.

Deri me datë 31.03.2024

Përgjigjja e institucionit:

Është mbyllur, gjë që është pasqyruar dhe me mbylljen e pasqyrave financiare për 2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i financës u konstatua se janë marrë masa për kryerjen e saktë për amortizimin e aktiveve të llog.218 “Inventar Ekonomik”.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **është zbatuar**.

7.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit/bashkisë si debitorët, duke i evidentuar në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2024

Përgjigjja e institucionit:

Është mbyllur, gjë që është pasqyruar dhe me mbylljen e pasqyrave financiare për 2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i financës u konstatua se janë marrë masa për kryerjen e saktë të veprimeve kontabël.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **është zbatuar**.

8. 1 Rekomandimi: Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së administrimit dhe menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete. Për pronat e transferuara në pronësi/përdorim Bashkisë Pustec me VKM të kryhen procedurat për evidentimin, inventarizimin, regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Korçë dhe në fund vlerësimin e tyre, si dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të pronave me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për menaxhimin e aseteve është ngarkuar Grupit Teknik të Punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë për përcaktimin e objekteve prioritet të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga bashkia u konstatua se nuk anë marrë masa për krijimin e strukturës së administrimit dhe menaxhimit të aseteve.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **nuk është zbatuar**.

9.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të rekomandimeve, që janë në proces zbatimi dhe rikërkojmë të marrën masa për zbatimin e rekomandimeve, që rezultojnë të zbatuara pjesërisht, si vijon:

- **Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
- **Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.
- **Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë**.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 1 dhe 2, nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, janë marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Komenti i grupit të auditimit:

Në lidhje me rekomandimin nr. 1 dhe 2 nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, janë marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve ku nga sektorët përkatës është hartuar regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi 1 dhe 2 konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi është zbatuar (trajtuar në mënyrë të detajuar në piken 1.1 të programit të auditimit)

Përgjigjja e institucionit:

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, janë marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve si dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga bashkia u konstatua se janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore si dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve, vlerë e cila është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi është në proces zbatimi (trajtuar në mënyrë të detajuar në piken 2.6 të programit të auditimit)

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën 19,653,980 lekë. Gjithashtu të marrë masa për raportimin në Sektorin e Financës të debitorëve, të shtesave apo pikësimeve vitit ushtrimor dhe të vitit paraardhës, me qëllim evidentimin dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023.

Deri me datë 31.03.2024

Përgjigjia e institucionit:

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, janë marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve si dhe kontabilizimin e gjendjes së saktë të debitorëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga bashkia u konstatua se janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore dhe për kontabilizimin e vlerës prej 1,577,700 lekë, vlerë e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi është zbatuar.

D. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a - “Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës si më poshtë:

- 1. Z. Q. Th.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.
- 2. Zj. E. A.** me detyrë inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- 3. Z. C. N.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

Përgjigjia e institucionit:

Për punonjësit për të cilën janë rekomanduar dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për 3 punonjës, nga Sektori i Burimeve Njerëzore *nuk është vijuar me fillimin e ecurisë disiplinore.*

Komenti i grupit të auditimit:

U verifikua nxjerrja e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore, nga ku rezultoi se nga struktura e burimeve njerëzore, përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve, nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore *për 3 punonjës të Bashkisë Pustec.*

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe rekomandimi **nuk është zbatuar.**

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, konkretisht Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Aktivitetet e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi dhe Raportimi, u konstatua se: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Bashkia Pustec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Etika në Bashkinë Pustec trajtohet në nenin 12 dhe 13 të Rregullores së Bashkisë, por nuk ka gjetur një trajtim të gjerë brenda kësaj Rregulloreje ose me anë të një dokumenti të veçantë miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në Bashkinë Pustec nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij. Bashkia Pustec nuk ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm. Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Nuk janë miratuar planet vjetore të punës. Nuk janë hartuar dhe miratuar Gjurmët Standarde të Auditimit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Pustec. *Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3., Kreu II paragrafi. 2.2.6; kap 5, Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27, neni 21, pika 2, nen 16, pika 2.*

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Koordinatori i MFK -së të merren masa për hartimin e një Kodi Etik, përditësimin e Rregullores së Bashkisë Pustec, duke përfshirë edhe Grupin për Menaxhimin Strategjik, miratimin e planeve të punës, hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, hartimin e një plani vjetor trajnimesh për stafin dhe realizimin e këtyre trajnimeve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi e veprimtarisë dhe sektorit të Auditit të Brendshëm, u konstatua se, nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Pustec, për vitin 2023 nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm, veprim në kundërshtim

me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe pikën 1, të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Në këto kushte rezulton se aktiviteti ekonomik dhe financiar i këtij institucioni nuk është audituar nga struktura të auditit të brendshëm. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësiti e menaxhimit të Bashkisë Pustec, u konstatua se kjo njësi vendore ka lidhur me shkresën me nr. 1326 prot, datë 10.10.2023 një Akt Marrëveshje me palë Bashkinë Devoll, për realizimin e auditimit të brendshëm në Bashkinë Pustec. Pavarësisht lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Devoll, për vitin 2023 nuk është kryer auditim mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare në Bashkinë Pustec, duke pasur në konsideratë faktin se kjo marrëveshje është lidhur dy muaj përpara mbarimit të vitit ushtrimor 2023. *Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 1, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 49.*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për kryerjen e auditimit nga struktura e auditit të Bashkisë Devoll për veprimtarinë ekonomiko-financiare, referuar Marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Devoll.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Mbi planifikimin e PBA-ve dhe Planeve vjetore me programe buxhetore sipas prioriteteve vendore dhe institucionale u konstatua se:

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e funksioneve të bashkisë dhe programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MFE, rezultoi se: fondet e buxhetuara për “policinë vendore” nuk janë përfshirë në programin përkatës 03140 – “shërbimet e policisë vendore”, fondet për drejtorinë e shërbimit urban dhe e shërbimeve publike ku përfshihet dhe IMTV nuk janë përfshirë në programin përkatës 06140 – “Planifikimi urban vendor”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1.

- Bashkia Pustec nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi programit 042 “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 056-“Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me 051-“Menaxhimi i mbetjeve”; 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 041-“Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” etj, të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritete nga bashkia Pustec. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 19-23, të raportit përfundimtar të auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e MFK, Koordinatorin e Riskut dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të miratojnë në Këshillin Bashkiak PBA dhe një Plan vjetor të buxhetit ku t’i kushtohet vëmendje planifikimit të fondeve për ato programe që

kanë të bëjnë kryesisht me ndërgjegjësimin mjedisor, shërbimin shëndetësor, tregjet, shërbimin urban, si dhe rritjes e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të pyllëzuara.

Brenda vitit 2024 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë për vitin 2023 u konstatua se:

- Nga dokumentacioni dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e parashikimit të të ardhurave, rezulton se të ardhurat e veta janë planifikuar për çdo vit të PBA 2023-2025 në të njëjtat vlera, si rezultat i mungesës së një analize të mirëfilltë të realizimit apo mosrealizimit të çdo takse e tarife vendore;

- Nga planifikimet fillestare sipas PBA-së dhe planit vjetor 2023, *rezulton se* Bashkia Pustec ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 6.5% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e veta të trashëguara nga viti paraardhës janë 5,230 mijë lekë. Të ardhurat e veta në total për vitin 2023 janë 13,230 mijë lekë ose në masën 10.8% të planit fillestar vjetor të miratuar; Nga fondet e “pakushtëzuara” janë planifikuar 435,364 mijë lekë dhe janë shpenzuar 391,875 mijë lekë ose 90% e tyre dhe nga fondet “specifike e sektoriale” janë planifikuar 82,098 mijë lekë dhe shpenzuar 45,383 mijë lekë ose 55.3% e tyre. Buxhetit vjetor i ndryshuar, është miratuar me vlerën totale për shpenzime të planifikuara bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2022 prej 527,732 mijë lekë.

- Ndërsa buxheti fillestar për vitin 2023 është planifikuar në vlerën e 122,595 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2022 prej 39,314 mijë lekë (nga të ardhurat e veta & transfertat e pakushtëzuar + tr.specifike e sektoriale) dhe transfertat shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 527,732 mijë lekë. Krahësuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 405,137 mijë lekë më shumë se ai fillestar dhe realizimi i tij në vlerën e 441,742 mijë lekë.

- Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, në vlerën 527,732 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 441,742 mijë lekë, duke sjellë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime respektivisht (-)45,142 mijë lekë dhe (-)86,128 mijë lekë, ndonëse vlera e mosrealizimit ka trend në rënie nga 77% në vitin 2022 në 83.7% në vitin 2023.

- Referuar pasqyrës së realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023 nga akt-rakordimet me thesarin, nga auditimi rezultoi se: niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 39.2% deri në 93.1% për vitin 2023; llog. 606 “transferime për buxhetet familjare dhe individë” ka realizimin më të lartë në masën 93.1% dhe llog.602 “shpenzime operative” ka mosrealizimin më të lartë në masën 39.2%.

- Nga auditimi i të dhënave për çdo zë buxhetor për 2 vite të njëpasnjëshme rezultoi se: Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 332,622 mijë lekë; Niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rritje nga viti 2022 në vitin 2023, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pustec dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2023 e zënë llog.230 e 231 – “Investimet” me 384,042 mijë lekë ose 72.8% e totalit të buxhetit, e ndjekur nga llog.600 “paga”

me 70,269 mijë lekë ose 13.3% të totalit të buxhetit; ndërsa në vlerat më të vogla janë llog. 609 “rezervat” me 770 mijë lekë ose 0.15%.

- Nga auditimi *rezultoi* se në vitin 2023 është nisur 1 projekt me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 1,059 mijë lekë; dhe 3 projekte me burim nga granti në vlerën totale 66,557 mijë lekë nga 7 në total në vlerën totale të planit të buxhetit vjetor 2023 prej 375,231 mijë lekë.

- Nga të dhënat e treguesve të tabelës së "të ardhurave të veta" dhe "transferts së pakushtëzuar", rezulton se mosrealizimi i fondit të planifikuar për “investimet” është në vlerën (-)35,556 mijë lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2022 shpenzimi i fondeve për këtë zë ka ardhur në rritje me 282,665 mijë lekë, që tregon jo vetëm për numrin në rritje të investimeve, por edhe për nevojat reale të bashkisë.

Gjithashtu rezulton se për vitin 2023 bashkia nuk ka arritur të shpenzojë fonde nga të ardhurat e veta për “investime”, gjë që tregon se nuk ka mundur të arkëtojë nga taksat dhe tarifat vendore vlerën e planifikuar prej 1,000 mijë lekë në total për zërin “investime”.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet (2022 dhe 2023) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 23-31 të raportit përfundimtar të auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori i Financës dhe buxhetit të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta mbi arsyet e realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në PBA 2023-2025/Planit vjetor 2023, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 “*planifikim për detyrimet e prapambetura*”, por është përllogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime. Mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për "mallrave e shërbime" e "investimeve" brenda afatit 60 ditor për mungesë fondesh, duke riskuar për lindjen e detyrimeve të reja. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet udhëzimeve përkatëse: Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 etj.

- Bashkia Pustec është debitorë për “investime” në vlerën 115,285 lekë, për 2 fatura (1 të vitit 2020 dhe 1 të vitit 2023), në tejkalim të afatit 60 ditor dhe e deklaruar si detyrim i prapambetur;

- Bashkia Pustec është debitore për “shërbime” postare (2 fatura 2019 dhe 2 fatura 2020), avokatie (1 faturë viti 2019), shërbime të tjera viti 2017, ëebinar i vitit 2021, në vlerën totale debitorë prej 696,633 lekë. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 23-31 të raportit përfundimtar të auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Sektori i Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për të parandaluar lindjen e detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MFE për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 500,918 lekë deri në fund të vitit 2024 dhe 311,000 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës; për të shmangur shpenzimet e panevojshme si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme.

Në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më realist të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Mbi organizimin e strukturave të hartimit, përlogaritjes dhe mbledhjes së taksave e tarifave vendore rezulton se:

- Sektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore/ Bashkia Pustec, për vitin 2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore. Nga auditimi rezulton se STTV ka në strukturën e tij 3 punonjës (1+2), ku një prej pozicioneve të inspektorëve ka qenë dhe vazhdon të jetë vakant, gjë që ndikon në performancën e aktivitetit të sektorit dhe në arritjen e objektivave institucionale;

- Sektori i Taksave e Tarifave/Bashkia Pustec informacionin tatimor e përpunon në paketën Microsoft Office 2013 - programi *excel*, i cili nuk plotëson kriteret bazë si një “Bartës informatik”. U konstatua se mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e STTV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh, familjarë, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj., në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3 pika 15, neni 7 dhe 8. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 31-34 të raportit përfundimtar të auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Sektori i Burimeve njerëzore të marrin masa për plotësimin sa më shpejt të vendit vakant në Sektorin e Taksave e Tarifave, për rritjen cilësore të veprimtarisë së tij dhe arritjen e objektivave institucionale.

- Titullari i Bashkisë dhe Sektori i taksave e tarifave në bashkëpunim me Sektorin e financës dhe buxhetit të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukturore, për miradministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave.

Menjëherë dhe në vijimësi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2023, u konstatua se:

- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 1,205 mijë lekë dhe është vjelë 592 mijë lekë ose në masën 49.1% të tij, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej (-)158 mijë lekë më pak se në vitin 2022 ose me (-)14.1%.

- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 1,302 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 460 mijë lekë ose në masën 35.4%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)193 mijë lekë ose me (-)14.8%.

- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 70 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 47.9 mijë lekë ose në masën 68.2%, me një rënie të ardhurash prej (-)5.8 mijë lekë nga viti 2022 ose prej (-)8.3%.

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 janë planifikuar 1,800 mijë lekë dhe janë realizuar 959 mijë lekë ose 53.3%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie të realizimit të të ardhurave prej (-)243 mijë lekë ose me (-)13.5%;

- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit janë planifikuar 800 mijë lekë dhe janë realizuar 383 mijë lekë ose 47.9%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)167 mijë lekë ose me (-)20.9%;

- Të ardhura nga tarifa të ndryshme: nga ujitje kullimi, nga shërbimet e MZSH, nga muzeu Nasi Lera, nga vozitje me varkën solar në liqen etj., janë planifikuar në total 354 mijë lekë dhe janë realizuar në total 208 mijë lekë ose në masën 58.8%, krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të të ardhurave prej 17.8 mijë lekë ose me 1.3%;

- Të ardhura nga kamatëvonesat janë planifikuar në vlerën 10 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 2 mijë lekë ose në masën 20.3%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej (-)2.7 mijë lekë ose prej (-)28.4%;

- Për vitin 2023 nuk janë parashikuar të ardhurat nga "tatim nga të ardhurat personale/TAP", e cila llogaritet mbi bazën e listë pagesave të punonjësve të strukturës aktuale të miratuar (kryesisht të muajit nëntor). Kjo ka ardhur nga mungesa e komunikimit efektiv mes SFB dhe STTV;

Mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e GMS për të ardhurat e (mos)realizuara në vitin 2022, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim, tokë bujqësore) konstatohet se Bashkia Pustec nuk ka lidhur marrëveshje me UK-sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në moszbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar;

- Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2023 rakordimet me DPSHTRR dhe ASHK Vendore, nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE. mosveprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-"Mbledhja me

forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 34-54 të raportit përfundimtar të auditimit).*

7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe STT të analizojnë me vëmendje të shtuar shkaqet që kanë sjellë mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave përkatëse sipas parashikimit vjetor, si dhe të marrin masa për hartimin e planeve strategjike vjetor jo vetëm për rritjen e të ardhurave nga arkëtimi i detyrimit vjetor të tatimpaguesve, por edhe për minimizimin e debisë progresive;

- Të lidhin marrëveshje me UK Korçë -sha në rolin e agentit tatimor, për vjeljen e taksa e tarifave vendore për abonentët familjarë;

- STT të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor me DPSHTRR dhe DV ASHK Korçë sipas formateve të miratuara nga MFE, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Pustec nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë sakte mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Pustec të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi.

8. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas Paketës fiskale të miratuar me VKB për vitin 2023, ndër të tjera u konstatua se Bashkia Pustec edhe pse ka në territorin e saj Liqenin e Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, nuk ka arritur për asnjë vit të sigurojë të ardhura nga peshkimi amator në ujërat e këtyre liqeneve. Nga STTV na u komunikua se janë bërë herë pas here përpjekje, por nuk është mundur të realizohet. Shoqata e peshkatarëve nuk ka pranuar të paguajë detyrimin vjetor ndaj Bashkisë Pustec ndonëse është në vlera modeste, e miratuar kjo me VKB në Paketat Fiskale vjetore. Për vitin 2023 është në vlerën 2,000 lekë.

Nisur nga ky fakt, grupi i auditimit duke iu referuar gjithë kuadrit ligjor në fuqi mbi peshkimin dhe akuakulturën, arriti në përfundimin se: në kuadrin ligjor të mësipërm, nuk përcaktohet qartë roli, përgjegjësia dhe përfitimet e njërive të vetëqeverisjes vendore /Bashkitë, në territorin e të cilave përfshihen formacione ujore detare, lumore apo liqenore, me qëllim sigurimin dhe rritjen e të ardhurave në buxhetin e tyre nëpërmjet tarifimit të llojeve të ndryshme të peshkimit si aktivitet jo vetëm tregtar, por edhe shlodhës-argëtues dhe studimor.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të parashtrijë tek Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore nevojën e bashkëpunimit për të rishikuar kuadrin ligjor lidhur me mundësinë e sigurimit të të ardhurave të NJVQV/Bashkive nga shfrytëzimi i resurseve ujore liqenore për të gjithë ata persona që nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë pajisur me leje për ushtrim aktiviteti të peshkimit pavarësisht llojit tregtar, shlodhës-argëtues apo atij studimor nga njëra anë, por dhe për një mirë menaxhim të këtyre burimeve në dobi të mjedisit dhe të cilësisë së jetës të komunitetit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të llogarive kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2023 sipas UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit

të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, u konstatua si më poshtë vijon:

- Pasqyrat financiare të Bashkisë Pustec janë përgatitur nga Sektori i financës dhe buxhetit dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Korçë për vitin ushtrimor 2023 me shkresën nr. 1137 prot., datë 30.08.2024 dhe miratuar datë 02.09.2024 nga Dega e Thesarit Korçë, në *tejkallim të afatit ligjor*;

- Me përfundimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara në vlerën 2,196,820.39 lekë, nga ana e SFB në hartimin e pasqyrave financiare nuk është bërë shkarkimi nga kontabiliteti i tyre në llogaritë përkatëse;

- Llog.470 “të ardhura për tu marrë” është nënvlerësuar për vlerën e llogarisë kundër parti - llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 22,486,478 lekë;

- Nga analiza e detajuar e gjendjes së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, përfshihet një kategori “debitorë të hershëm” në shumën 129,768 lekë, për dieta të 33 këshilltarëve të ish komunave. Konstatohet se nga SFB nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS mbi hartimin e një plani masash, për të mundësuar arkëtimin e shumës 129,768 lekë në buxhetin e bashkisë;

- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve *konstatohet se* :

Në llog.218 “inventar ekonomik” vlera prej 982,001 lekë që përfshin inventarë të kësaj llogarie të dalë jashtë përdorimit, nuk janë pasqyruar në pasqyrat format 7/a e 7/b në rubrikën “pakësime”, duke e pasqyruar të mbivlerësuar në shumën 982,001 lekë, kur në fakt duhet të pasqyrohej në shumën 8,115,671.94 lekë;

Në llog.218 “inventar ekonomik” janë regjistruar gabimisht 39 aktive të llojit “fond biblioteke-libra” në vlerën totale 12,650 lekë, të cilat duhej të regjistroheshin në llog.212/nënlllog.2120 “krijim fond biblioteke” me koeficient amortizimi prej 5%. Pra llog. 218 është mbivlerësuar për shumën prej 12,650 lekë.

Nga analiza e llog.218 “inventar ekonomik” rezulton se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndare si nënkategori më vete [llog.2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë;

- Llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” në pasqyrat financiare është paraqitur pa vlerë. Nga auditimi konstatohet se Bashkia Pustec në QKB sipas Ekstraktit të datës 13.12.2024 paraqitet si Aksionere me 0.64% e UK Pustec sha- tani “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë” sha me NUIS -“M24431001N” e cila është shoqëri aksionare me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Dhe se vlera e aksioneve vazhdon të mos jetë regjistruar në llogarinë 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” “Numri i aksioneve është 640 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 64,000 lekë, për të cilën llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 54-70 të raportit përfundimtar të auditimit).

9.1 Rekomandim: Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masa që me mbylljen e vitit ushtrimor:

Të hartojnë pasqyrat financiare dhe ti dorëzojnë në Degën e Thesarit Korçë brenda afatit ligjor;

Të shkarkojë nga kontabiliteti vlerën e aktiveve të dëmtuara të cilat i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit dhe pasqyrimin të vlerës prej 2,196,820.39 lekë në llogaritë kontabël përkatëse të pasqyrave Format 7/a e 7/b, rubrika “pakësime”;

Të pasqyrojë në llog.470 “të ardhura për tu marrë” të pasqyrës Format 1 “Pozicioni Financiar” shumën e llog. 468 "debitorë të ndryshëm" prej 22,486,478 lekë;

Të parashtrojë në takimet e GMS problematikën e vlerës debitore të hershme prej 129,768 lekë, për marrjen e masave konkrete për të mundësuar arkëtimin e saj në buxhetin e bashkisë;

Të sistemojë në llog.212 “objekte e konstruksione” 39 aktive të llojit “fond biblioteke-libra” për të cilat llog. 218 “inventar ekonomik” është mbivlerësuar për shumën prej 12,650 lekë;

Me kalimin e këtyre aktiveve në llog.212 “objekte e konstruksione” të rillogaritët amortizimi për secilin vit në pasqyrat financiare për periudhën nga 2018 e në vijim me normën e amortizimit 5%, për të patur një pasqyrim real të vlerës neto të aktivitetit dhe të vlerës së akumuluar të amortizimit për çdo llogari kontabël në pasqyrat respektive;

Në llog. 218 "Inventari ekonomik" të klasifikojë veçmas llog. 218/6 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aktiveve të njësisë dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive;

Të pasqyrojë në llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” vlerën e 640 aksioneve në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë” shumën e 64,000 lekë, e vlerësuar sipas Ekstraktit të QKB.

Deri më datë 31.03.2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llog. 466 “kreditorë për mjete në ruajtje” rezulton se nga 18 projekte investimesh në total në vlerën 9,079,596 lekë deri në 31.12.2023 ka disa projekte investimesh për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i plotë përkatës që kryesisht e përbëjnë projektet e transferuara nga ish Komunitat (para vitit 2015). Për këto projekte nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë: GMS, Sektori i urbanistikës dhe Sektori i financës dhe buxhetit nuk është bërë asnjë analizë e situatës për marrjen e masave konkrete për zhbllokimin e kësaj llogarie. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 54-70 të raportit përfundimtar të auditimit).*

10.1 Rekomandim: Në Bashkinë Pustec, GMS, Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i Financës në bashkëpunim me juristët në Sektorin e Burimeve njerëzore, të marrin masa konkrete për zhbllokimin e llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” veçanërisht për projekt investimet e hershme të trashëguara nga ish komunitat.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës, nga auditimi i dokumentacionit për veprimet me arkën u konstatua se shuma e arkëtuar e lekëve e depozituar në zyrën e financës, e kalon vlerën ditore limit të gjendjes së arkës dhe se nga ana e zyrës së financës së bashkisë derdha në bankë nuk bëhet brenda ditës apo ditën pasardhëse, por duke grumbulluar arkëtimet e javës, duke riskuar kështu sigurinë e cash-it në ambientet e bashkisë. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 54-70 të raportit përfundimtar të auditimit).*

11.1 Rekomandim: Sektori i Financës dhe buxhetit në bashkëpunim me Sektorin e Taksave e tarifave vendore, të marrin masa që veprimet me arkën dhe bankën të kryhen sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pustec (Sektori i Financës) nuk ka parashikuar dhe përlllogaritur në buxhet kostot e nevojshme për pagesën e tarifës për përgatitjen e plan rilevimit nga subjektet e licencuara për 148 pasuri që janë në listën e inventarit të bashkisë Pustec, për ti dorëzuar pranë DV ASHK Korçë, për të bërë të mundur transferimin në pronësi të bashkisë Pustec me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin e kësaj Bashkie, përcaktuar në prioritetet e investimeve dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në zbatim të pikës 1.2/a të nenit 9 dhe me piken 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3.4, faqe 74-82 të raportit përfundimtar të auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Pustec (Sektori i Financës dhe i Buxhetit) të parashikoj dhe të përlllogarisë në buxhetin e ardhshëm kostot e nevojshme për përgatitjen e plan rilevimit për 148 që janë në listën e inventarit të bashkisë Pustec, që më pas të dorëzohen pranë DV ASHK Korçë, që kjo e fundit ti dërgoj për miratim në Këshillin e Ministrave.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në emër të Bashkisë Pustec janë transferuar me VKM nr. 433 datë 8/06/2016, një sipërfaqe prej 272.4 ha pasuri Pyll dhe Kullote, nga ana e bashkisë nuk është bërë e mundur shfrytëzimi apo tjetërsimi i kësaj sipërfaqe për faktin se e gjithë sipërfaqja është brenda territorit të Zonës së Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës, miratuar me VKM nr. 80, datë 18.02.1999, ku nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura edhe pse ka një kërkesë nga bashkia nuk është kthyer një përgjigje dhe nuk ka një masë konkrete për saktësimin e pasurive, për të bërë të mundur që Bashkia Pustec të ketë mundësi shfrytëzimi dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3.4, faqe 74-82 të projekt raportit të auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Bashkia Pustec ti kërkoj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të përcaktojnë dhe të saktësojnë pasuritë brenda zonës së mbrojtur, për të bërë të mundur që Bashkia Pustec të ketë mundësi shfrytëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në juridiksionin e Bashkinë Pustec janë gjithsej 19 pasuri të transferuar në pronësi të miratuar me VKM, nga këto është aplikuar nga bashkia për pajisje me certifikatë pronësie në DV ASHK Korçë vetëm 3 pasuri, ndërsa për 16 pasuri nga ana e bashkisë nuk është aplikuar, që do të thotë që për këto pasuri nga Bashkia Pustec nuk është përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk ka aplikim për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Korçë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.SH”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3.4, faqe 74-82 të raportit përfundimtar të auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Bashkia Pustec të aplikoj pranë DV ASHK Korçë për 16 pasuri, për pajisje me certifikatë pronësie për pronat e paluajtshme që janë në pronësi të Bashkisë Pustec të miratuar me VKM, ku pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të

regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pustec, nuk ka evidentuar pasuritë për çdo zonë kadastrale për rrjedhojë nuk është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjor për pasuritë, (pronave publike), për të bërë të mundur përmirësimin dhe saktësimin e kufijve, të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme, pasqyrimin të drejtë në hartën kadastrale të pozicionit gjeografik, si dhe saktësimin të të dhënave të regjistrin të pasurive, mbështetur në pikën 2 të nenit 35 ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjë hapësinor në RSH”, dhe të VKM-së nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3.4, faqe 74-82 të raportit përfundimtar të auditimit)

15.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Pustec të merren masat për evidentimin dhe verifikimin e gjendjes faktike në terren të pasurive për çdo zonë kadastrale me qëllim përmirësimin dhe saktësimin e kufijve, të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme dhe dërgimin e tyre pranë DV ASHK Korçë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Pustec mungon sektori i menaxhimit të aseteve, por kjo detyrë i është ngarkuar Grupit Teknik të Punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 “Mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec”. Nga grupi teknik i punës (part time) nuk ka qenë e mundur përballimi i këtij procesi voluminoz të inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme publike në juridiksionin e Bashkisë Pustec, që do të thotë se puna e grupit teknik të punës nuk ka qenë efiçente, duke mos përmbushur detyrimet e përcaktuar në urdhrin e kryetarit.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së administrimit dhe menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pustec, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 4, faqe 82-90 të raportit përfundimtar të auditimit).

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pustec, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm paraqitur me shkresën nr. 1028/7, prot, datë 05.02.2023, rezulton se:

-Nga masa organizative të rekomanduara gjithsej 12:

-7 janë zbatuar plotësisht dhe 4 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.

-Nga 1 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) e rekomanduar, është zbatuar.

-Nga 3 masë disiplinore, rezulton të pa zbatuar 3 masa.

Niveli i pranimi të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 61.5 %. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 79-91 të raportit përfundimtar të auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të rekomandimeve dhe ri kërkojmë të marren masa për zbatimin e rekomandimeve, që rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe 1 të pa zbatuar, si vijon:

17.2. Rekomandimi: Titullari i institucionit me atributet e Kryetarit të GMS, të marrë masa të menjëhershme, që të njohë punonjësit me aktet ligjore e nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

17.3. Rekomandimi: Të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.

17.4. Rekomandimi: Të ndjekë me rigozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

17.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për kryerjen e auditimit nga struktura e auditit të Bashkisë Devoll për veprimtarinë ekonomiko-financiare, referuar Marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Devoll.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.6. Rekomandimi: Sektorit burimeve njerëzore të nxjerr vendim për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore, për 3 punonjës të Bashkisë Pustec.

Menjëherë

17.7. Rekomandimi: Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi, në Bashkinë Pustec (plan veprimi i miratuar nga Kryetari i Bashkisë) të raportohet në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të kryet brenda afatit 6/mujor.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi:

- Mbi nivelin e detyrimeve vjetore nga auditimi rezulton se gjendja e debitorëve familjarë në mbyllje të vitit 2023 për (taksa e ndërtesës + taksa e tokës bujqësore + taksa familjare) është në vlerën totale 3,629,807 lekë dhe vlera totale progresive 21,951,101 lekë për 1319 debitorë; duhet theksuar fakti që vlera e debisë progresive ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 si në total edhe për çdo kategori të taksës familjare.

- Nga analiza e debitorëve, rezulton se në Bashkinë Pustec nuk ka takime të dokumentuara të GMS ku të trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

- Nga auditimi rezulton se Bashkia Pustec për vitin 2023 ka patur të njëjtin numër biznesesh prej 19 në total, prej të cilëve 18 janë biznes i vogël, 1 është biznes i madh dhe 2 institucione në vlerën totale 81,183 lekë nga biznesi dhe 20,000 lekë nga institucionet; kanë mbyllur aktivitetin

me pezullim apo çregjistrim 4 subjekte debitorë, për të cilët nga ana e QKB janë kryer veprimet pa konfirmuar më parë statusin e tyre debitorë ose jo nga ana e STTV të Bashkisë Pustec.

- Në fund të vitit 2023 në Bashkinë Pustec (9 fshatrat), janë 11 subjekte debitorë në vlerën totale 346,609 lekë me të njëjtin numër debitorësh si edhe në vitin 2022, por me rritje të vlerës së debisë me 46,417 lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

1 subjekt “Biznesi i Madh” në vlerën 132,840 lekë, krahasuar me vitin 2022 debia ka vlerë në rritje prej 36,510 lekë; 10 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 213,769 lekë krahasuar me vitin 2022 debia ka vlerë në rritje prej 9,907 lekë; 2 subjekte “Institucione” në vlerën 59,000 lekë krahasuar me vitin 2022 dhe ka vlerë në rritje prej 2,000 lekë.

- Nga një klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur rezultoi se:

Për BV janë 10 debitorë problematikë në vlerën totale 213,769 lekë;

Për BM është 1 debitor problematik në vlerën 132,840 lekë (përfaqësohet me subjektin "P. T.").

Në total janë 11 debitorë problematik në vlerën totale 346,609 lekë. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 42-54, të raportit përfundimtar të auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Sektori i Taksa e Tarifave Vendore në bashkëpunim me juristen në Sektorin e Burimeve njerëzore, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj debitorëve problematikë për arkëtimin e shumës progresive 346,609 lekë.

1.2 Rekomandimi: Sektori i Taksa e Tarifave Vendore të përditësojë planin periodik dhe vjetor të punës për të siguruar vjeljen brenda afateve të përcaktuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor si për familjarë edhe për biznesin; për rritjen e arkëtimeve nga ana e debitorëve për të minimizuar vlerën progresive të debisë prej 21,951,101 lekë për 1319 debitorët familjarë dhe 59,000 lekë për 2 Institucionet debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT